**Abstenim.....**

**Me 57 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 30.

**Votojmë tash:**

**Për.....60**

**Kundër.....0**

**Abstenim.....**

**Me 60 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 31.

**Votojmë tash:**

**Për.....56**

**Kundër.....0**

**Abstenim.....**

**Me 56 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 32.

**Votojmë tash:**

**Për.....61**

**Kundër.....0**

**Abstenim.....**

**Me 61 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 33.

**Votojmë tash:**

**Për.....62**

**Kundër.....0**

**Abstenim.....**

**Me 62 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 34.

**Votojmë tash:**

**Për.....60**

**Kundër.....0**

**Abstenim.....**

**Me 60 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 35.

**Votojmë tash:**

**Për.....59**

**Kundër.....0**

**Abstenim.....**

**Me 59 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 36.

**Votojmë tash:**

**Për.....65**

**Kundër.....0**

**Abstenim.....**

**Me 65 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 37.

**Votojmë tash:**

**Për.....62**

**Kundër.....1**

**Abstenim.....**

**Me 62 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 38.

**Votojmë tash:**

**Për.....62**

**Kundër.....1**

**Abstenim.....**

**Me 62 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 39.

**Votojmë tash:**

**Për.....64**

**Kundër.....0**

**Abstenim.....**

**Me 64 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 40.

**Votojmë tash:**

**Për.....62**

**Kundër.....1**  
**Abstenim.....**  
**Me 62 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 41.

**Votojmë tash:**  
**Për.....62**  
**Kundër.....0**  
**Abstenim.....**  
**Me 62 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 42.

**Votojmë tash:**  
**Për.....61**  
**Kundër.....0**  
**Abstenim.....**  
**Me 61 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 43.

**Votojmë tash:**  
**Për.....66**  
**Kundër.....0**  
**Abstenim.....**  
**Me 66 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 44.

**Votojmë tash:**  
**Për.....62**  
**Kundër.....1**  
**Abstenim.....**  
**Me 62 vota për dhe 1 kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 45.

**Votojmë tash:**  
**Për.....64**  
**Kundër.....1**  
**Abstenim.....**  
**Me 65 vota për dhe 1. kundër kalon amendamenti.**

**Aktualisht në sallë janë 77 deputet**  
Amendamenti nr. 46.

**Votojmë tash:**

**Për.....67**

**Kundër.....1**

**abstenim.....**

**Me 67 vota për dhe një kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 47.

**Votojmë tash:**

**Për.....60**

**Kundër.....0**

**Abstenim.....**

**Me 60 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 48.

**Votojmë tash:**

**Për.....64**

**Kundër.....0**

**Abstenim.....**

**Me 64 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

Amendamenti nr. 49.

**Votojmë tash:**

**Për.....66**

**Kundër.....0**

**Abstenim.....**

**Me 66 vota për dhe asnjë kundër kalon amendamenti.**

**Shkojmë në aprovimin e tekstit në tërësi bashkë me amendamentet e propozuara:**

**Në sallë janë 79 deputet**

**Votojmë tash:**

**Për.....70**

**Kundër.....0**

**Abstenim.....9**

**Me 70 vota për dhe asnjë kundër aprovohet teksti bashkë me amendamentet e parashtruara.**

**Konstatohet se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për shpronësimin me interes publik. Ju faleminderit!**

**Atëherë ,propozoj paузë deri në orën 13,30**

KRYETARI KOLË BERISHA – Lus deputetët që t’i zënë vendet.  
Konstatohet se në sallë janë 70 deputetë, kështu që mund të fillojmë punën.

Pika e 8 e rendit të ditës.

### **8. Shqyrtimi i propozimit të G/P të AAK-së për miratimin e Rezolutës për organizimin e diasporës kosovare (e bartur nga seanca e 26 janarit 2007).**

Në pajtim me rregullat 6.5 dhe 32.2 të Rregullores së punës, Grupi Parlamentar i AAK-së i është drejtuar Kuvendit me kërkesë të përsëritur dhe me propozim përmbajtësor për miratimin e Rezolutës për organizimin e diasporës kosovare dhe bashkëpunimin me institucionet e Kosovës.

Kërkesa dhe teksti i Rezolutës u është shpërndarë deputetëve me kohë. Ftoj përfaqësuesin e mocionit ta marrë fjalën.

GJYLNAZE SYLA - I nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë, e nderuara kryesi e Kuvendit, së pari dëshiroj t’ju falënderoj edhe pse me një vonesë prej 7 muajsh kjo pikë e rendit të ditës është futur në agjendën e Kuvendit. 7 muaj janë kohë e gjatë dhe koha është e kushtueshme për ne në Kosovë e sidomos në procesin në të cilin tani gjendemi, por . po ashtu është e çmueshme për qytetarët tanë jashtë vendit të cilët i kanë të drejtuar sytë nga ne dhe presin veprime konkrete. Jemi të bindur se qytetarëve tanë të cilët jetojnë dhe punojnë jashtë Kosovës ,u kemi borxh një përqendrim më të madh institucional. Diaspora e Kosovës ka qenë ajo që në vitet tona më të vështira e ka mbajtur të gjallë rezistencën tonë politike dhe atë ushtarake. Edhe sot është duke e dhënë kontributin e saj të palodhshëm në promovimin e çështjes së Kosovës, në mbështetjen e ekonomisë dhe të familjeve kosovare. Për këtë kontribut të jashtëzakonshëm të qytetarëve tanë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit kemi respekt dhe i falënderojmë sinqerisht. Po ashtu jemi të bindur se qytetarët e Kosovës edhe pse jashtë vendit ndiejnë dhe i përjetojnë hallet dhe sfidat tona ,me të cilat po ballafaqohemi në ndërtimin e shtetit. Në këto momente kur Kosova po e shkruan historinë e saj ndihma dhe angazhimi i qytetarëve jashtë vendit për jetësimin e ëndrrës sonë të përbashkët është e nevojshme si kurrë më parë. Pa dyshim se ata janë duke u angazhuar maksimalisht ,duke cenuar edhe kërkesat e tyre themelore jetësore me qëllim që t’i ndihmojnë familjet e tyre dhe institucionet legjitime të Kosovës në përballimin e sfidave. Për këtë duhet të jemi mirënjohës dhe kjo mirënjohje nuk mjafton të shprehet vetëm me fjalë. Këta qytetarë e kanë të drejtën e tyre legjitime dhe e meritojnë në kuptimin e plotë të fjalës që të marrin pjesë në vendimmarrjen në Kosovë, prandaj është koha që institucionet e Kosovës të punojnë për të bashkëpunuar më ngushtë me diasporën. Grupi Parlamentar i Aleancës i ka parashtruar Kuvendit një rezolutë e cila kërkon organizimin institucional të diasporës kosovare, pjesëmarrjen e saj në jetën politike në Kosovë, privilegjet që të investojnë në Kosovë dhe të trajtohen me prioritet në rast të kërkesave të tyre për pajisje me dokumentacionin përkatës nga organet qendrore dhe komunale. Ky është minimumi që duhet të bëjmë për diasporën. Për këtë arsye më lejoni që në vijim në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës të propozoj Projektrezolutën për organizimin e diasporës kosovare dhe bashkëpunimin me institucionet e Kosovës.

Duke rikujtuar shpërnguljen pa dëshirë të detyruar të qytetarëve të Kosovës në periudha të ndryshme , duke vlerësuar lart sakrificat e diasporës për mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të Kosovës, duke u bazuar në kontributin e diasporës kosovare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, duke marrë parasysh se mbështetja financiare dhe solidariteti i diasporës mundësuan mbijetesën fizike dhe ekonomike të popullit të Kosovës ,duke konfirmuar ndihmën e jashtëzakonshme të diasporës për ndërtimin e institucioneve të Kosovës ,me qëllim të inkurajimit të diasporës kosovare për organizimin institucional dhe të qëndrueshëm për t'iu përshtatur zhvillimeve të reja dhe që kontributi i tyre të jetë efikas në zhvillimin e Kosovës, Kuvendi i Kosovës nxjerr rezolutë për organizimin e diasporës kosovare dhe bashkëpunimin me institucionet e Kosovës.

1. Kuvendi i Kosovës kërkon nga Qeveria e Kosovës që të hartojë ligjin për organizimin e diasporës në mënyrë institucionale;
2. Kuvendi i Kosovës, duke u bazuar në Ligjin për organizimin e diasporës, rekomandon krijimin e mekanizmave të diasporës, të cilat do të bashkëpunojnë ngushtë me institucionet e Kosovës në promovimin dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës;
3. Kuvendi i Kosovës nxit Qeverinë që të zhvilloj politika stimuluese, të favorshme për investimet e diasporës në Kosovë;
4. Kuvendi i Kosovës mbështet iniciativën për krijimin e këshillit konsultativ ekonomik të përbërë nga biznesmenët e shquar kosovarë në diasporë dhe miqtë e shquar të huaj;
5. Kuvendi i Kosovës fton Qeverinë e Kosovës që në kuadër të projektit për regjistrimin e popullsisë të inkorporojë planin për regjistrimin e popullatës së Kosovës jashtë vendit;
6. Kuvendi i Kosovës garanton të drejtën me ligj të kosovarëve që jetojnë jashtë vendit për të marrë pjesë në votimet në Kosovë;
7. Kuvendi i Kosovës garanton që në listat zgjedhore për Kuvendin e Kosovës të përfshihen edhe qytetarët nga diaspora;
8. Me propozim të Kuvendit të Kosovës, kryetari i Kosovës, një herë në vit, ndan çmimin për diasporën, për kontributin e dalluar në të mirë të Kosovës;
9. Kuvendi i Kosovës kërkon nga Qeveria që t'ia lehtësojë diasporës rregullimin e çështjeve administrative dhe përmes internetit të siguroj qasjen në informatat për shërbimet publike, për investimet e mundshme, vendet turistike, kulturën dhe letërsinë e Kosovës.

Të nderuar deputetë, ne shpresojmë në mbështetjen tuaj për këtë iniciativë. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, sipas procedurës lidhur me propozimin në fjalë është paraqitur në emër të LDK-së Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – I nderuari z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë. Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar propozimin e Rezolutës të cilën e ka sponsoruar Grupi Parlamentar i AAK-së.

Të gjithë ne jemi të interesuar që mërgimtarëve apo qytetarëve tanë, që jetojnë në diasporë t’ua lehtësojmë kushtet e jetesës e këto kushte do të lehtësohen nëse ata organizohen në mënyrë institucionale dhe nëse po në mënyrë institucionale rregullohet statusi i tyre në vendin ku jetojnë dhe punojnë përkohësisht dhe në Kosovë, pra në bashkëpunim me vendet ku ata jetojnë dhe punojnë. Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet Rezolutën e propozuar nga AAK-së, ndonëse kjo rezolutë nuk është e përcjellë me ndonjë material i cili do ta arsyetonte më mirë tekstin e hartuar të Rezolutës, e kjo imponon që ne të organizohemi një ditë dhe të takohemi ose nesër përfaqësuesit e grupeve parlamentare në mënyrë që ta shkurtojmë pak tekstin e rezolutës. Pra, t’i përfshijmë në këtë tekst të rezolutës vetëm ato që mund t’i përmbajë një rezolutë, sepse pjesët e tjera i përkasin rregullimit me ligj, kurse, siç dihet LDK-ja ka propozuar gati para një viti Ligjin për diasporën, por akoma nuk është hartuar. Si do që të jetë e përhëndesim iniciativën e AAK-së, ndërkaq për tekstin e rezolutës do të duhej të ulemi dhe të punojmë dhe të heqim nga ajo të gjitha premisat që duhet t’i përfshijë ligji. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit znj. Kelmendi. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës fjalën e ka Hydajet Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – I nderuari z. kryesues. Znj. e z. deputetë Grupi Parlamentar i PDK-së mbështet në parim çdo nismë që është në favor të organizimit më të mirë të segmenteve të rëndësishme të shoqërisë kosovare ,siç është mërgata dhe avancimi sidomos i përkujdesjes për të. I mbështesim ,madje edhe kur nuk është krejt e zakonshme, kur nuk është më e mira me rezolutë. Merreni me mend sa çështje ne do të duhej t’i shtronim me rezoluta, meritojnë të shtrohen, por nuk është mënyra më e mirë sidomos të bëhet prej forcave politike që janë pjesë e koalicionit qeverisës, sepse ato e kanë edhe instrumentin institucional për përkujdesjen e tyre dhe do të duhej të kërkohet në radhë të parë që të funksionalizohen segmentet institucionale. Siç e dini Grupi Parlamentar i PDK-së e ka aktualizuar këtë çështje edhe në formë pyetjesh parlamentare, pikërisht për t’i sensibilizuar ministrinë dhe Qeverinë në tërësi për një përkujdesje meritorë për mërgatën. Unë e quaj krejt të panevojshme të flasim këtu tash për rëndësinë që ka mërgata, për kontributin e saj ,sepse është çështje që ju është e njohur të gjithëve, është diçka që është notore nuk mund të kontestohet. Është edhe Projekti i PDK-së dhe i Kabinetit të qeverisjes nën hije që tanimë është bërë publik dhe janë propozime konkrete, do të ishte e udhës që ato të ishin përfshirë në tekstin e propozuar të Rezolutës. Do të ishte më mirë meqë është një çështje që u përket të gjitha grupeve parlamentare që edhe si rezolutë të ishte një përbërje e përbashkët e të gjitha grupeve parlamentare, sepse është çështje që na përket të gjithëve. Prandaj le të shfrytëzohen këto raste që na përkasin të gjithëve, ku kemi qëllim të përbashkët të dalim me zë të bashkuar. Megjithatë e kuptoj



edhe lojën politike dhe përkundër kësaj ne e mbështesim. Ajo që unë do të dëshiroja të theksoj këtu veçanërisht është nevoja që mërgimtarët tanë të trajtohen në mënyrë të barabartë, si edhe të gjithë të tjerët dhe jo të ndahen në baza etnike, jo një pjesë të konsiderohen të zhvendosur, një pjesë refugjatë dhe trajtimi të jetë krejt i ndryshëm. Ju e dini çka do të thotë kjo. Për më tepër do të ishte normale dhe unë kam pritur që përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të AAK-së të shtrojnë se ç'po ndodh sot në organizimin qeveritar dhe karshi mërgatës. Një departament që ka qenë dhe që ka qenë menduar të kthehet në ministri, tani praktikisht po shuhet, asnjë fjalë nuk u tha. Pse bëhet kjo? Ai departament ka qenë i radhitur ndër segmentet që kanë shënuar suksese që kanë zënë vend në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm, dy e tri herë më shumë. Ministri ka pas thënë këtu se tani do të gjenden forma më moderne elektronike, pse nuk u bën ato? Unë prandaj duke e mbështetur nismën e duke e mbështetur edhe orientimin që ta harmonizojmë dhe ta bëjmë qëndrim të përbashkët, mendoj se pos trajtimit të njëjtë të gjithë njerëzve tanë që janë jashtë vendit dhe jo sipas përkatësive etnike, duhet të kërkohet që Drejtoria e mërgatës e çështjeve jorezidente "MASAFT" të jetë pjesë e kabinetit të kryeministrit. siç është në shumë vende dhe të ketë trajtim meritore, të parandalohet edhe rrënimi i asaj që është bërë në këtë departament. Shfrytëzoj rastin që këtë kërkesë t'ua bëj drejtpërdrejt kryeministrit dhe Qeverisë në përgjithësi, i bindur se edhe do ta kem mirëkuptimin dhe mbështetjen tuaj. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit. Në emër të Grupit Parlamentar "Ora" Teuta Sahatqija.

**DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA** – Faleminderit z. kryesues, kolegë deputetë.

Diaspora është faktor i rëndësishëm në shoqërinë kosovare, roli i saj është i fuqishëm si para luftës, e posaçërisht gjatë luftës, por edhe sot pas luftës. Si në aspektin e mbështetjes morale, politike po ashtu edhe nga pikëpamja ekonomike. Është për të ardhur keq që pikërisht diaspora e cila ka qenë gjithmonë me ne kur ne e kemi pasur vështirë dhe kur kemi pasur nevojë për të nuk ka gjetur vendin e vet të merituar në agjendën e Qeverisë. Më lejoni që t'i lexoj ata 10 rreshta të programit të Qeverisë së tre kryeministrave që vijnë prej radhëve të propozuesit të rezolutës.

Duke pasur parasysh kontributin e madh të diasporës në të kaluarën dhe nevojën për integrimin e saj në rrjedhat shoqërore – ekonomike dhe politike të vendit, Qeveria do të shtojë përpjekjet për organizimin institucional të jetës së tyre. Ky është programi 2004-2008.

Mbështetjen e projekteve që kanë të bëjnë me organizimin e mësimin plotësues, të aktiviteteve kulturore, ruajtjen e trashëgimisë historike dhe kombëtare dhe të një komunikimi të ndërsjellë me vendin.

Të një rëndësie të veçantë do të jenë përpjekjet për të tejkaluar problemet e diasporës, etj, etj, në 10 rreshtat e programit.

Diaspora meriton të ketë një qasje të organizuar, program, strategji afatgjate, qasje të rregulluar me ligj, ligj të cilin Qeveria kur e sheh të arsyeshme që ajo është prioritet e fut në planin e vet legjislativ, ashtu siç ka premtuar edhe në planin e vet qeveritar. Sa e di unë Qeveria nuk e ka paraparë ligjin për diasporën në planin e vet për 2007. Do të ishte mirë që t'i udhëzoni anëtarët e propozuesit që përbëjnë Qeverinë për ligjin për diasporën, ta qesin si çështje prioritare për 2008, pasi në programin për 2007 Qeveria nuk e ka futur

diasporën në rend dite. Këtu dëgjuam se qe 7 muaj pret rezoluta për të ardhur në Kuvend. Në fakt programi qeveritar është prej 2004, diaspora është duke pritur shumë më gjatë që të trajtohet në Qeveri. Për ligjin për diasporën që është një çështje shumë e rëndësishme ,asnjë deputet i asnjë partie nuk ka kundërshtim dhe ky ligj do të duhej të kalonte pa kurrfarë intervenimi në Kuvend. Do të ishte normale që opozita të sillte një rezolutë të tillë në aprovim në Kuvend dhe përmes kësaj ta detyrojë Qeverinë e cila nuk është prej radhëve të veta që ta sjellë ligjin. Por duket cinike nga ana e koalicionit të kërkojë ndihmën e Kuvendit për ta detyruar Qeverinë e vet të përbërë prej anëtarëve të partisë së vet që ta punojnë ligjin. A ka nevojë koalicioni i cili e bie këtë rezolutë në Kuvend për votat e opozitës, për ta detyruar, për ta bindur Qeverinë dhe kryeministrin, i cili është nga radhët e veta që diaspora ka nevojë për ligj. Po të kishte kërkuar kryeministri për shkak se të kishte deklaruar dhe kërkuar prej nesh që është i pafuqishëm për shkak të iks, iks gjërave, atëherë do të ishte e arsyeshme që Kuvendi të merret me këtë çështje. Qytetarët tanë në diasporë jetojnë në vendet ku demokracia, institucionet shtetërore funksionojnë dhe ata e dinë si funksionon sistemi dhe i dinë procedurat ligjore, ata nuk meritojnë të nënçmohen me këtë qasje, me rezoluta të cilat nuk e obligojnë askënd të trajtohet çështja e tyre. Për shkak të qasjes joserioze ne nuk mund ta mbështesim këtë nismë dhe do të abstenojmë. Ju lutem të jeni seriozë dhe të mos e nënçmoni diasporën.

**KRYESUESI, XHAVIT HALITI –** Faleminderit znj. deputete. Për fjalë në emër të Grupit Parlamentar 6+ deputeti Xhezair Murati.

**DEPUTETI, XHEZAIR MURATI –** G. Presedavajući, kolege poslanici. Parlamentarna grupa 6+ je včrlo detalno analizirala zahtev Parlamentarne Grupe Alianse vzano za instituiconalno rešavanje i povezivanje diaspore sa institucijama Kosova i upšte sa Kosovom kao domovinu. Mi kao parlamentarna grupa s obzirom da se znatan broj naših građana takođe iz naših zajednica nalaze u glavnom u zemljama zapadne srednje i severne Evrope, podržavamo ovakav zahtev ali da on dobija zakonsku formu i institucionalnu formu kako bih i pripadnici ostalih zajednica bili u prilici da na institucionalan način svoja uddruženja koja imaju formirana svoje zajednice i klubove da se povežu sa maticom i to na institucionalan način kako bih zaštitili svoj jezik, svoj identitet, kulturna, verska i druga prava. Hvala vam.

**KRYESUESI, XHAVIT HALITI –** Ju faleminderit. Fjalën e ka Gjergj Dedaj.

**DEPUTETI GJERGJ DEDAJ –** Faleminderit z. kryesues. Grupi Parlamentar për Integrim konsideron se diaspora është një pjesë e dhimbshme jona e cila posaçërisht pas lufte ka ngelur e injoruar dhe në margjina të përkujdesjes institucionale nga të gjitha qeveritë e derisotshme, të cilat kanë udhëhequr Kosovën. Nuk është mirë ndoshta që diasporën ta shfrytëzojmë vetëm për marketing politik dhe para fushatave për t'ua lehtësuar xhepat. Është mirë të mendojmë shumë seriozisht për këtë pjesë e cila e ka mbajtur Kosovën gjatë luftës dhe para luftës ,por edhe shumë më herët, por edhe tash e kësaj dite e posaçërisht me kontributet e tyre për ndërtimin e Kosovës dhe kontributet e tjera që i japin për Kosovën. Është mirë ndoshta që të vihet në pah konkretisht çka kanë bërë qeveritë e Kosovës për një shembull shumë konkret. Sa herë që vijnë njerëzit tanë nga diaspora në pushime, mundem me thënë se pushimet i kalojnë para sporteve për të

nxjerrë një dokument të thjeshtë të lindjes ose të vdekjes ose një certifikatë familjare dhe të mos flasim se duhet së paku 10 fish t'i paguajnë biletat e udhëtimit kur vijmë për festa, bajram, krishtlindje, pashkë ose për vit të ri ose në pushime gjatë gushtit, sepse matrapazët e agjencive turistike gjatë dimrit kur nuk kanë udhëtarë i kanë biletat ta zëmë për Zvicër 90 franga, ndërsa në gusht dhe për festa deri 900 franga. Të mos të flasim për një familje 6 apo 7 anëtarëshe mund të udhëtoj, d.m.th gjysmën e fitimit vjetor duhet me e pagu për bileta. Kjo është forma se si e kemi trajtuar dhe si e trajton Qeveria e Kosovës diasporën. Nuk mund të zgjidhet problemi i diasporës me rezoluta, sepse rezolutat siç e dini janë akte që nuk e obligojnë askënd. Ne i kemi disa rezoluta që i ka aprovuar Kuvendi i Kosovës, të cilat e kanë vetëm rëndësinë arkivore, janë diku të pluhurosura dhe sinqerisht kjo që e tha deputetja Sahatqija është shumë e qëndrueshme dhe tregon qartë se si qeveritë e Kosovës dhe tash për tash qeveria aktuale e trajton diasporën që është krejtësisht e harruar.

Diaspora ka qenë e privuar edhe nga e drejta elementare njerëzore që është e drejta për votë dhe e drejta për të qenë të zgjedhur dhe të përzgjedhur. Ata nuk kanë pasur të drejtë vote mundem me thënë përqindjen e sakët dhe mundem me spekuluar, por ndoshta as 2% apo 3% të diasporës kanë votuar gjatë zgjedhjeve të fundit për liderët dhe partitë politike në Kosovë, d.m.th ka qenë skandaloze, kjo ka qenë një mospërfillje dhe mundem me thënë fyese dhe një denigrim i të drejtave elementare të njerëzve tanë të cilët gjithmonë kanë qenë dhe janë ata të cilët e kanë mbajtur në çdo formë Kosovën.

Kjo rezolutë mundem me thënë pa keqkuptim dhe i kërkoj falje Grupit Parlamentar të AAK-së nëse e keqinterpretojnë kjo është vetëm një marketing politik që bëhet tash që dikujt i nevojitet dhe nuk ka nevojë të nxirret një rezolut, por të përgatitet seriozisht dhe të hyn në prioritet çështja e ligjit për diasporën nga Qeveria e Kosovës. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Dedaj. Për fjalë është paraqitur Emrush Xhemajli.**

**DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – I nderuari kryesues, të nderuar kolegë deputet dhe ju që jeni prezent këtu ju përshëndes. E përshëndeti edhe nismën në Kuvendin e Kosovës për nxjerrjen e ligjit që i kushtohet diasporës, qytetarëve të Kosovës që janë jashtë vendit dhe ju bashkangjitem kërkesave që Qeveria e Kosovës në afatin më të shkurtër ta përgatis këtë ligj dhe ta bjen në aprovim. Bashkohem me të gjithë ata që dhanë vërejtje këtu rreth formës që është shtruar, por asesi rreth përmbajtjes ose rreth asaj se për shkak se nuk është ditur që të prezantohet këtu në formën e duhur, tash të shkohet në abstenim ose në kundërshtim, përkundrazi këtu së bashku ta marrim një vendim edhe ta caktojmë një afat 3 mujor që të silllet këtu ligji. Ju faleminderit.**

**KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Faleminderit z. Xhemajli, për fjalë është paraqitur Xhevat Bislimi.**

**DEPUTETI XHEVAT BISLIMI - Faleminderit z. kryesues, z. deputet.**

Unë do ta kundërshtoj kolegen që na prezantoi këtë Projektrezolutë. Në terminologji puna e parë duhet ta ndajmë çka është diaspora dhe që janë mërgimtarët tanë, refugjatët e dëbuar, shpërngulur nga dhuna dhe represioni serb në Kosovë. Diaspora mund të jenë shqiptarët e shpërngulur në Turqi, diaspora mund të jenë arbëreshët e Italisë, por

shqiptarët e shpërngulur nga represioni serb e veçmas ose të paktën nga viti 1981 e këndeje nuk mund të quhen diasporë, por janë refugjat shqiptarë nga Kosova të cilët duhet të trajtohen si refugjat dhe kjo Qeveri, ky Kuvend ka detyrim kombëtar, moral, njerëzor që për këta njerëz të ndajë fonde të krijoj kushte për ata që duan të kthehen dhe të jetojnë në vendin e tyre, sepse janë shpërngulur nga dhuna. Ky Kuvend dhe kjo Qeveri e sidomos ky koalicion qeverisës të paktën minimumin që duhet të bëjë për atë pjesë të dhimbshme të kombit tonë duhet të tregoj kujdesin që tregon të paktën për pakicën serbe ose për refugjatët e quajtur ish kolonët e dikurshëm serb të shpërngulur nga Kosova dhe që kanë shkuar në vendin e tyre. Të njëjtin kujdes ky Kuvend duhet të tregoj edhe për pakicat tjera nga Kosova që janë shpërngulur në rrethana lufte, në rrethana represioni dhe të ndajë fonde që ata shqiptarë tash më të shpërngulur që duan të rrijnë atje, që kanë vendosur të rrijnë në vende të huaja të ndihmohen që ta ruajnë identitetin e tyre gjuhësor, kulturor, kombëtar etj. Në këtë kuptim përdorimi i emrit Kosovar është i paqëndrueshëm sepse ata janë shqiptarë dhe askush në botë nuk ka të drejtë që të paktën shqiptarët e shpërngulur t'i kualifikoj mbi baza krahinore, jo Tetovar, Kosovar sepse ata atje janë shqiptarë dhe asgjë më shumë.

Të kihet parasysh fakti që këta shqiptarë të shpërngulu, jo të shpërngulur vetëm deri në vitin 1999, por edhe mija tjerë që janë shpërngulur dhe vazhdojnë për çdo ditë të shpërngulen dhe askush nuk e bën llaf. Në vendet ku shkojnë sot zyrtarisht janë serb vëllezër shqiptar dhe ju tjerë pakicave që jeni këtu, ata të gjithë në Francë, Gjermani, Zvicër, Itali sot pas pavarësimit të Malit të Zi shkruhen qytetar serb dhe për këtë duhet ta ngritë zërin koalicioni qeverisës dhe zonja apo zonjusha që na paraqiti atë rezolutë, kjo është çështja e jo të derdhim lot krokodili për ata, se ata nuk kanë nevojë për lotët tanë, nuk është çështja që ne si e ka menduar zonjusha edhe sot të mendojmë se si t'i vjelim ata, por se si t'ju krijojmë kushte që të kthehen në shtëpitë e tyre, në vendin e tyre. Si t'u garantojmë deklaram të lirë në vendet ku shkojnë dhe të deklarohen shqiptarë e jo serb ose serbo Montenegro si janë deklaruar dhe nëse para kësaj hesitet kot na lodhni me këto paçavure se mërgata jonë dhe refugjatët tanë nuk kanë nevojë të flladiten me rezoluta as të AAK-së dhe as të Qeverisë. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit. Për replikë është lajmëruar Gjylnaze Sylja.

**DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA** – Faleminderit z. kryesues. Unë nuk mendoj që diaspora është e ndarë në çështje të pozitës dhe opozitës, çështja e diasporës është çështje e të gjithë neve dhe besoj se këtu pajtohemi të gjithë, dua të falënderoj LDK-së për mbështetjen e iniciativës, por jam e sigurt se edhe Partia Demokratike së paku kështu janë deklaruar në media se janë të interesuar. Z. Hyseni nëse është llojë politike pse ju jeni deklaruar njëjtë. Sa i përket kontrollës dhe Qeverisë unë dua t'ju theksoj se pushtetet të nderuar deputet, pushtetet janë të ndarë, Qeveria dhe Parlamenti dhe pikërisht se jemi në pozitë e kemi përgjegjësin me e kontroll Qeverinë më shumë dhe me i sugjeruar Qeverisë për të punuar më shumë. E nderuara znj. Sahatçia ju nuk jeni më e bindshme në goftë se i bini tavolinës dhe nëse flisni me zë më të lartë, më vjen shumë keq që çështjen e diasporës e konsideroni si çështje jo serioze.

Rezoluta mund të jetë referuese dhe obligative, vetë fakti që neni i parë i rezolutës ndihmon ose i udhëzon Qeverisë për ta bërë ligjin për diasporën, flet për një veprim

konkret. Z. Bislimi është e qartë që ju nuk e keni lexuar aspak rezolutën, për atë dhe vërejtjet e juaja ishin shumë të varfëra. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Hydajet Hyseni, 1 minut replikë.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Unë dua ta falënderoj znj. Sylja për mundësinë që ma dha për të plotësuar qëndrimet e mia. Unë nuk e di se ku e kamë thënë në media se e mbështes një nismë të tillë, por unë thash këtu në Kuvend dhe e kamë thënë edhe sa herë tjera se mbështes çdo hap, çdo nismë që është në favor të një organizimi më të mirë të mërgatës sonë. Por tërheq vërejtjen se kjo përkujdesje, ky angazhim duhet të jetë serioz, i përgjegjshëm, gjithëpërfshirës dhe institucional siç u tha këtu me ligj dhe nuk mund të bëhet kjo znj duke mos e pasur as ministrin dhe duke harruar këtë fakt, le t'i shkundim ata që janë të angazhuar për këtë, të mos i lejojmë ata që ta rrënojnë edhe atë që është bërë për interesat e vogla politike etj dhe kjo është mënyra më e mirë që ne të flasim sy me sy e ballëhapur me mërgatën të cilës vërtet siç u tha këtu i kemi shumë, shumë borxh, por edhe kemi nevojë për të.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. Hyseni. Teuta Sahatçia e ka fjalën.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Faleminderit z. kryesues, faleminderit që m'u dha prapë rasti se më pat mbet edhe diçka pa thanë. Z. Hyseni tha për seriozitetin e kësaj qasjeje tregon edhe djathtas, majtas Qeveria nuk është këtu, tregon programi në të cilin janë 10 rreshta, tregon prej 2004 nuk e ka trajtuar Qeveria. Në qoftë se unë i përdor me zë të naltë apo me gjeste, mendoj se çdokush ka të drejtë me u shprehë si don, por nuk ka të drejtë të luajë me diasporën. ORA nuk është kundër diasporës, ajo e mbështet diasporën, është kundër qasjes joserioze që të shfrytëzohet diaspora për poenat e lirë politike.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Faleminderit, fjalën e ka z. Bislimi.

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Faleminderit z. kryesues. Unë e pranoj publikisht që duke qëndruar në këtë sallë me deputetë të varfër, si është Gjylnazja që ka marrë diçka nga varfëria e tyre. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Për fjalë është paraqitur Berat Luzha.

DEPUTETI BERAT LUZHA – Mua më vjen keq që propozuesja e një rezolute për diasporën ,siç thotë ajo, nuk e kupton fjalën diasporë se çka do të thotë. Do ta rekomandojsha ta shikojë fjalorin për shkak se diaspora ka kuptim krejt tjetër. Diasporë janë ngulimet e një populli jashtë trungut kombëtar, kurse në këtë rast kemi të bëjmë me mërgatën ose emigracionin e Kosovës që jeton nëpër botë. Edhe unë mendoj se materia e këtij propozimi rregullohet jo me rezolutë, por me ligj dhe askush nuk e ka penguar Qeverinë që të bëjë një ligj për mërgatën dhe një ligj i tillë për ne do të ishte shumë i mirëseardhur dhe i pranueshëm e i zbatueshëm. Pse nuk e ka bërë këtë ligj deri më tash Qeveria dhe çka pret që nuk e bën, a e ka në plan dhe a e ka parasysh se duhet ta bëjë sa më parë, për shkak se askush nuk e mohon rolin dhe kontributin e mërgatës në çështjen e

Kosovës, prandaj mendoj se ky propozim është joserioz dhe me shumë demagogji politike, kështu që si i tillë nuk meriton të votohet. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Ju faleminderit. Znj. Gjylnaze Syla kërkon prapë replikë.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Z. kryesues mendoj që ia keni borxh publikut se çka është diaspora e çka emigracioni. Unë e kam pasur shumë të qartë kur e kam shkruar rezolutën. Diaspora është kur shkëputet, por popullata është e vendosur, kurse emigracioni ka të bëjë me popullatën e cila është ende në lëvizje dhe atëherë dihet se për çka është rezoluta ime. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Fjalën e kërkon z. Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit z. kryesues, e nderuara Qeveri që mungon, ndoshta e përcjell dikush në ndonjë restorant nëse e kanë lëshuar.

Të nderuar deputetë pak ka qytetarë të Kosovës të cilët e përcjellin punën e Kuvendit të Kosovës më shumë se njerëzit tanë që janë të vendosur jashtë, tash si do t'i themi diasporë, mërgatë kjo është çështje e simpoziumeve gjuhësore.

Po i referohemi termit që e ka përdor referuesja e rezolutës. Pak ka njerëz që e përcjellin dhe ma me ndjeshmëri punën e Kuvendit dhe jam i sigurt se ka prej tyre shumë që kur e kanë dëgjuar nismën e znj. Syla që tha se unë e kam shkruar dhe po e trajtoj si nismë të saj personale, kanë thënë se erdhi momenti dhe dikush do të bëjë diçka për ne. Thelbi qëndron te qasja, koncepti, por kjo qasje është joserioze, qasje e cila nuk i bën nder kësaj partie që i jep tre kryeministra, prej të parit Ramush Haradinaj, Bajram Kosumi dhe Agim Çeku. Nuk e di se çfarë relacioni kanë këta në partinë e tyre me kryeministrat që vijnë nga radhët e tyre. A komunikojnë me ata kryeministra, a e analizojnë punën e tyre në parti apo u japin detyra apo jo, a kërkojnë nga ata që detyrat që i marrin nga kryesia e partisë t'i zbatojnë? Këto relacione komunikuese në partinë e tyre e kanë prurë këtë rezolutë këtu. Duket se ata nuk komunikojnë fare me partinë e vet, përndryshe nuk ka kuptim. Nëse në programin qeveritar është thënë që Qeveria do të bëjë çmos që të ndër marrë masa për institucionalizimin e marrëdhënieve me diasporën dhe ndërkohë nuk është bërë asnjë hap në atë drejtim dhe tash vjen propozimi nga grupi i cili e jep kryeministrin këtu në Kuvend dhe kërkon ndihmën e Kuvendit për ta obliguar Qeverinë, diçka këtu nuk shkon, diçka këtu nuk është në rregull, diçka është ofendim për inteligjencën e njeriut normal, pra duhet të thuhet që Qeveria është munduar, kryeministri ka bërë përpjekje maksimale nuk ia ka dalë dhe ka nevojë për ndihmë të Kuvendit, në rrethanat kur kryeministri nuk e ka dhënë asnjë dëshmi që ka punuar në drejtim të sanksionimit ligjor të punës ose të diasporës dhe të marrëdhënieve tona me diasporën dhe tash vjen nga shefja e grupit parlamentar të partisë që e jep kryeministrin dhe merret nisma. Kjo është totalisht joserioze -e tha z. Luzha, demagogjike, çdo fjalë që mund të përdoret në këtë situatë i fle, prandaj të jemi pak ma seriozë, të jemi pak ma respektues ndaj atyre njerëzve që realisht edhe sot e mbajnë ekonominë e Kosovës në këmbë, njerëzit të cilët me punën e me djersën e vet çojnë kontributet në familjet tona dhe që kjo ekonomi shërbimesh që është vetëm ekonomi shërbimesh mbahet vetëm prej parave të tyre. Të mos bëhemi aq përbuzës dhe aq injorues ndaj asaj sakrifice të atyre

njerëzve që e kanë bërë në të kaluarën dhe po e bëjnë edhe sot dhe sigurisht që kanë me bërë edhe në të ardhmen për këtë vend. Të gjithë ne kemi pasur rast kush më shumë e kush më pak të jetojmë në diasporë dhe e dimë atë ndjeshmëri, e kemi përjetuar atë ndjeshmëri, jemi gjetur në situata të ndryshme. E kemi marrë radion dhe jemi përpjekur që ta dëgjojmë një lajm të mirë nga Kosova, të jemi aq abuzues të kësaj ndjenje të atyre njerëzve atje, por të jemi më seriozë dhe studiozë, t'i drejtojmë çështjet atje ku duhet drejtuar, të kërkohet në vijë partiake më së pari përderisa Agim Çeku është kryeministër që vjen nga partia, ju duhet ta detyroni Agim Çekun si parti që ta bëjë punën e vet, sepse Qeveria i bën këto punë, e nëse Agim Çeku nuk mundet për shkak të pengesave të jashtme le të vijë e të thotë në Kuvend se nuk po mund ta kryejë këtë punë, kam nevojë për përkrahjen e Kuvendit, vetëm në këtë mënyrë ne do t'i japim përkrahje një nisme të tillë, në rrethana çfarë është propozuar këtu ne nuk mund t'i japim përkrahje një pune joserioze. Kjo është punë e cila duhet të injorohet nga ky Kuvend.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Faleminderit. Znj. Sylja

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Dëshiroj të sqaroj. Grupi Parlamentar i AAK-së me këtë rezolutë kërkon mbështetjen për qasje institucionale, për këtë çështje kërkojmë edhe mbështetje të organit më të lartë të Kosovës, Kuvendit të Kosovës. Për të ndryshuar qasjen nuk mjafton vetëm ligji apo vetëm ajo që ka bërë Qeveria, përkujdesja për diasporën është përgjegjësi e të gjithë neve.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Fjalën e ka deputeti Sabit Rrahmani

DEPUTETI SABIT RRAHMANI – Ju faleminderit z. kryesues.

Unë do të kyçem pak te fjala e z. Bislimi edhe pse e di se nuk e ka pasur me qëllim të caktuar duke e përmend gjithmonë vetëm kombin, sakrificën e kombit shqiptar. Unë e respektoj vullnetin e tij me të vërtetë, por edhe ai vetë e respekton sakrificën që e ka bërë komuniteti shqiptar kur Kosova ka qenë nën okupim dhe kontributin e komunitetit shqiptar në Kosovë. Unë desha me dhanë vetëm një sqarim lidhur me atë që kanë kontribuar edhe komunitetet e tjera, një shifër që e kemi ne prej 2514 personave që kemi mund me arritë deri te kjo shifër nga komuniteti ashkali, është një shumë që është derdhur në Kosovë mbi 2. 7.000.000 € prej këtij komuniteti, d.m.th normalisht edhe komunitetet e tjera, kështu që nëse një rezolutë apo një ligj nuk i përfshin interesat e të gjitha komuniteteve që janë në mërgatë apo diasporë për komunitetet joserbe. me siguri se do të jetë i papranueshëm. Këtu po dëgjohej shumë zëra që rezoluta që e ka përgatitur AAK-ja nuk po përkrahet nga disa grupe parlamentare. Kam një propozim konkret: Nëse kjo rezolutë grupeve parlamentare nuk u pëlqen, Grupit Parlamentar për Integrim, ORA-s, PDK-së apo pa marrë parasysh, atëherë le t'u jepet kohë grupeve parlamentare që t'i japin pikëpamjet e tyre dhe cilat pika ata dëshirojnë që ta bëjnë një rezolutë të përbashkët Kuvendi i Kosovës me të gjitha grupet parlamentare, përndryshe nëse edhe kjo nuk mund të bëhet, atëherë pajtohem me propozimin e Emrush Xhemajlit nga LPK-ja që t'i jepet kohë Qeverisë për një afat 3- mujor që ta përgatit ligjin për diasporën. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI- Ju faleminderit. Caktojmë 10 minuta pushim.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Të nderuar deputetë.zini vendet se po vazhdojmë seancën.

Për fjalë është paraqitur deputeti Sabri Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryesuesi i seancës, faleminderit. Unë dëgjova me vëmendje kolegët e mi pa marrë parasysh ngjyrimin dhe temperamentin në të cilin ata diskutojnë për një problem ,megjithatë nuk mendoj se mund të krijohet përshtypja që nuk shikohet ky problem me seriozitetin e vërtetë që e ka. Unë dua t'i them dy -tri fjalë rreth kësaj kërkesë ,sepse më takon, duke qenë se jam edhe anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

Tërheq vëmendjen që kjo iniciativë është e verës së vitit të kaluar dhe ata që lexojnë mirë mund të shohin që është bërë më datën 5 korrik 2006, pse e them këtë, e them këtë sepse kërkesa ka kaluar një procedurë parlamentare nëpër Kryesi derisa ka ardhur në një seancë të këtyllë plenare.

Kryesia e Kuvendit herën e parë ka menduar ashtu qysh thanë shumë deputetë sot këtu, që paraprakisht të merret neni 1 i kësaj ku kërkohet të hartohet ligj për diasporën dhe t'i drejtohet Qeverisë dhe Kryesia e Kuvendit i është drejtuar Qeverisë me kërkesën që të hartohet Ligji për diasporën dhe kjo kërkesë e Kuvendit ekziston te Qeveria. Asokohe ne kërkonim që të hartohet ky ligj, ndërsa pjesët që mund të rekomandohen si vendim i Kuvendit më vonë të rrëshqasin në seancë parlamentare. Me që ligjin deri më sot nuk e kemi. Unë mendoj që seanca parlamentare mund të rikonfirmojë edhe një herë kërkesën që të hartohet Ligji për diasporën.

E dyta, pse unë e mbështesë këtë, e mbështesë këtë se edhe në kërkesën e kësaj rezolute që mbetet të propozohet eventualisht në marrëveshje me të gjitha grupet parlamentare ekzistojnë dy pika themelore që vërtet rekomandojnë probleme të rëndësishme substanciale që kanë të bëjnë me diasporën dhe lidhjen e saj me institucionin e Kosovës. Këto janë e drejta për të zgjedhur dhe e drejta për t'u zgjedhur, këto janë probleme shumë të mëdha të cilat natyrisht që nuk do të zgjidhen në këtë seancë, por do të zgjidhen me marrëveshje të institucioneve të Kosovës marrëveshje e cila me ligj, të bëhet dokument obligativ.

Duke pasur parasysh këtë histori disamujore rreth këtij insistimi që raporti i institucional i institucioneve të Kosovës me diasporën të kthehet në ligj ,pra në obligim. Unë mendoj që është e udhës që Parlamenti, të gjitha grupet parlamentare nëse nuk e pranojnë këtë formulim që e kemi përpara si propozim nga një grup, ta plotësojnë dhe të harmonizojnë një tekst i cili mund edhe të mos votohet sot po të votohet në mbledhjen e ardhshme. Faleminderit z. kryesues.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Tani nuk ka diskutues të tjerë. Në goftë se më lejohet do të kisha diskutuar edhe unë në lidhje me propozimin dhe me domosdoshmërinë e miratimit jo vetëm të rezolutës. Më lejoni që nga foltorja këtu të flas.



Unë e mbështes çdo iniciativë e cila e vë në vendin e duhur emigracionin shqiptar që nga viti 1945 i arratisur jashtë trojeve të veta e deri më sot. Po e them këtë sepse shumë herë po harrojmë që nga ky emigracion ,i cili është arratisur me pushkë në dorë nga Kosova për në gjë të Greqisë, është shpërndarë anekënd botës dhe ka vepruar nëpër subjekte të organizuara atje. Deri më tash institucionet e Kosovës nuk e kanë thënë asnjë fjalë. Me qenë se është kompetencë jona dhe në veçanti e presidentit të Kosovës, unë mendoj që me një medalje apo dekoratë të veçantë presidenti i Kosovës do të duhej t'i dekoronte: Ballin Kombëtar, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit në Mërgim, Komitetin e Kosovës, Partinë e Legalitetit, Organizatën Marksiste Leniniste të Kosovës, Lëvizjen Popullore të Kosovës, Degën e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Degën e Partisë Demokratiane të Kosovës dhe të gjitha klubet shqiptare që kanë vepruar të shkëputura nga Jugosllavia.

Me porosi të veçantë nga Parlamenti i Kosovës ose me rekomandim të veçantë mendoj që do të duhej të dekoroheshin fondet të cilat e kanë mbajtur jetën të gjallë në Kosovë dhe fondi i cili e ka mbajtur luftën në Kosovë. Për grumbullimin e mjeteve e kam fjalën te 3%, duke vlerësuar angazhimin e madh të një grupi vullnetarësh të dërguar edhe nga Kosova edhe nga diaspora për të krijuar fond kombëtar, të dekorohen të gjithë anëtarët nismëtarë të fondit kombëtar të Kosovës i cili më vonë u quajt fondi i 3%. Të dekorohen të gjithë kryetarët e këtyre fondeve nëpër shtete të veçanta. Dhe dekoratat të mos jepen paushall ,por të jepen mbi bazën e fakteve dhe të argumenteve të cilat ish Qeveria në mërgim dhe Kryesia e Lidhjes Demokratike dhe Kolegjiumi i Degëve që e kanë pasë mbi bazën e dëshmimeve të dekorohen me dekorata të veçanta.

Për Fondin Vendlindja Thërret. të gjithë anëtarët ose të gjithë drejtuesit e Fondit Vendlindja Thërret nga TMK-ja dhe nga Shoqata e Veteranëve të Kosovës të dekorohen me dekorata të veçanta sipas rregullave që i kanë të brendshme të krahasuara barabarësisht me ata që kanë luftuar në Kosovë duke u reshtuar në hierarkinë e duhur sipas vendimeve të cilat mund të merren dhe në konsultim të ngushtë me udhëheqjen e Fondit të 3% dhe me Kryesinë e Degës së Lëvizjes Popullore të Kosovës në Mërgim.

Për mbajtjen e arsimit në diasporë. Mendoj se presidenti i Kosovës e ka për obligim që të gjithë mësuesit dhe gjithë aktivistit e të ashtuquajturës atëherë si ka qenë Lidhja e Arsimtarëve të Kosovës t'i dekorojë me dekorata të veçanta. T'i dekorojë të gjithë ata kryetar klubesh të cilët janë shkëputur me vetëdije nga lidhjet që i kanë pasë me ambasadat e Jugosllavisë, të dekorohen të gjithë udhëheqësit ose t'i quaj redaktorët e gazetave të cilat kanë dalë në diasporë të organizuara nga mërgimtarët dhe në veçanti do të thosha “Lajmëtar i lirisë” Zëri i Kosovës,” Liria,” Famuri,” Kosova, pra të shihet mundësia e dekorimit të të gjitha organeve të cilat kanë qenë oponente e pushtuesve në Kosovë dhe janë botuar në diasporë që nga Australia dhe në Evropë.

Sa i përket rezolutës mendoj që është pak për diasporën, është pak për shumë arsye të cilat i dimë të gjithë dhe nuk dua të flas dhe të konsiderohen që po e keqpërdori për elektorat as për diçka tjetër. Megjithatë mendoj që përkufizimi ose afatizimi që duhet t'i bëhet Qeverisë për ta miratuar Ligjin për diasporën është i domosdoshëm. Është i domosdoshëm për shumë arsye. Po e them vetëm një shembull. Një aktiviste e vjetër emigrante ta quaj e lindur dhe e rritur në Mitrovicë, një muaj është përpjekë me nxjerrë

letërnjoftimin dhe nuk ka arritë me e nxjerrë, sepse i kanë lypë njëqindmijë dokumente, njëqindmijë dëshmi që është shqiptare nga Kosova. Ajo është e lindur , e rritur dhe e shkollume në Mitrovicë dhe ka ikë jashtë dhe me ligj të gjithë qytetarët e Kosovës të cilët kanë lindur në Kosovë kanë të drejtë që edhe bashkëshortët e tyre edhe fëmijët e tyre të kenë shtetësi të Kosovës. Unë nuk e kuptoj si funksionon administrata përmenda Mitrovicën ,sepse nga kjo janë ankuar më shumë, pothuaj se gjithkund po respektohen do farë rregulloresh informale të cilat nuk e kanë parasysh ligjin.

Pra, në planin e shërbimeve në të gjitha qytetet e Kosovës, në të gjitha zyrat civile të Kosovës ,duhet të përqendrohemi për një përkushtim të vëmendjes dhe ky duhet të bëhet me ligj.

Dhe dy, të shihet mundësia ,jo për ta zhvesh, jo për t'u kërkuar atyre që kanë mundësi dhe donë të kthehen dhe të investojnë në Kosovë përqindje ,por t'u bëjmë lehtësime të mëdha me ligj. Këto lehtësime besoj që shumica nga ne i dimë që i kanë bërë edhe regjimit të së kaluarës, sepse vërtet Kosova ka njerëz të cilët në diasporë kanë mjete financiare, janë të shkolluar atje dhe mendoj që Kosova ka nevojë për trurin e shkolluar në Perëndim, ka nevojë për t'u krijuar hapësirë investimeve të tyre.

Prandaj, këtu do të thosha që propozimet për ta harmonizuar tekstin e projekt rezolutës janë të mirëseardhura ,por në qoftë se ne nuk e miratojmë një ligj dhe nuk e afatizojmë të paktën brenda 120 –ditësh, ta miratojmë një ligj për diasporën mendoj se do ta zvarritim këtë pa fund, kështu siç e kemi zvarritë edhe çështjen e rezolutës dhe propozimet që i ka bërë Kabineti i Qeverisjes së Mirë. Faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Gjergj e ke krye po më duket. Z. Sylja është paraqitur besoj me dhënë mendimin përmbyllës se çfarë po propozon.

**DEPUTETIJA GJYLNAZE SYLA** – Faleminderit z. kryesues. Mendoj që nga ky debat propozimi ishte shumë i mirë i z. Sabri Hamitit dhe ne pajtohemi me këtë. Prandaj ju lutem vëni në votim këtë propozim.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Tani janë paraqitur edhe 3 diskutues, Alush Gashi në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

**DEPUTETI ALUSH GASHI** – I nderuari z. kryesues. Grupi ynë parlamentar këtë nismë në të gjitha fazat ka miratuar, duke ditur rëndësinë e saj. dhe në fillim të seancës në emër të grupit deputetja z. Nekibe Kelmendi e ka shpreh qëndrimin. Ne debatin e kemi përcjellë me shumë kujdes dhe në fund z. Sabri Hamiti ka dhënë një propozim shumë konkret. Prandaj ju kisha lutë që propozimin e Sabri Hamitit ta hidhni në votim, na jepni kohë që si deputetë,si grupe parlamentare të merremi me këtë çështje. Ne mund të vendosim së bashku me Kryesinë si të gjitha grupet, por edhe me Kryesi të bisedojmë për atë që ish porosi e të gjithëve.. Porosia e të gjithëve sot ish se kjo çështje duhet të rregullohet me ligj. Ne ndoshta mund të merremi vesh në fund që Kuvendi të dalë me një vendim që t'i japë afat Qeverisë për sa ditë me pru draftligj këtu apo mund të del ashtu siç u bë kërkesa me një rezolutë me pas një tekst më të gjerë sa me ia plotësuar një

qëllim një subjekti politik. Porosia e debatit sot është që kjo çështje duhet të rregullohet me ligj dhe këtu nuk ka dyshim në bazë të saj çka kam dëgjuar sot.

Prandaj z. kryesues. në emër të Grupit Parlamentar të LDK lus që ta hedhësh në votim propozimin e deputetit Sabri Hamit. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Emrush Xhemajli.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Faleminderit z. kryesues. Mendoj se nuk ka nevojë për zvarritje edhe për takime të mëtutjeshme të grupeve parlamentare për shkak se të gjithë thatë edhe jemi dakord që kjo çështje të kalojë përmes ligjit. Këtu dy gjëra lypen të votohen që të bëhet ligj dhe të afatizohet, për tjetër send nuk e vlen të diskutohet tash për përmbajtjen e ligjit ,se këtu u diskutua shumë për pika të ndryshme që kish me përmbajtje ligji, ajo shumë e panevojshme kur të vijë ligji ne do të diskutojmë, kështu që të lutem me hedh në votim këtë propozim ,sepse nuk ka nevojë më për shtyrje.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Atëherë e hedh në votim. Janë dy propozime realisht deri tash për diasporën. Harmonizimi i tekstit të prezantuar nga grupet ose nga AAK-ja do të thotë të harmonizohet teksti nga grupet parlamentare, siç e dha propozimin z. Sabri Hamiti dhe është një kërkesë që të kërkohet nga Qeveria ose përmes rezolutës, pastaj mund të futet që të afatizohet koha e nxjerrjes së ligjit nga Qeveria për diasporën. Mendoj që të dyja veç e veç duhet të votohen ose i bëjmë të dyja bashkë dhe i votojmë, po janë dy propozime për të njëjtën çështje, njëra është për rregullore dhe tjera për ligjin. Nuk mund të votohen edhe ligji edhe rregullorja and bllok mendoj.

Atëherë, mendoj që propozimi për afatizimin për ligjin, në kuadër të diskutimeve që do t'i bëjnë grupet parlamentare me njëra- tjetrën për rregullimin e tekstit të projektrezolutës mund të futet edhe afatizimi që brenda 3 muajve ose 120 ditëve të vihet ligji i Qeverisë. Urdhëro z. Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryesues unë mendoj se kam qenë tepër, tepër i qartë dhe kur ta shihni tekstin çka kam thanë, ju do ta shihni që ato çka t'i po i lyp i kam bërë në kërkesë, por të folurit është me kohë direkt dhe mund t'i ju kalojë diçka që s'e keni kapë, do me thanë unë po them që brenda saj bile pikë numër 1 të mbetet hartimi i ligjit, por meqë sot është e pamundur kohësisht që grupet parlamentare të merren vesh për tekstin e rezolutës, t'u jepet kjo shans t'u pasë përmbajtje brenda edhe këtë pikë numër 1, Sa e pashë unë kisha mbështetjen e propozuesit ,kryetares së Grupit të AAK-ës dhe natyrisht të kryetarit të Grupit Parlamentar të LDK-ës. Unë të lus që këtë formulim që e specifikova edhe një herë ta qitësh në votim.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. E dëgjuam të gjithë propozimin ,atëherë hedhim në votim propozimin e specifikuar nga deputeti Sabri Hamiti. Kush është për propozimin e z. Hamiti?

Mendoj se shumica janë për propozimin. Kush është kundër? S'ka kundër propozimit. Abstenim a ka? 4 vota janë abstenim

Konsideroj që me shumicë të votave propozimi miratohet.

Në sallë janë 80 deputetë dhe shpresoj që deri në seancën e ardhshme kryetarët e grupeve parlamentare do të takohen do ta harmonizojnë dhe s'do të zvarritin më tutje miratimin e rezolutës dhe rekomandimin për ta nxjerrë ligjin. Faleminderit.

Z. Krasniqi me kartelë të Enver Hoxhajt.

DEPUTETI JAKUP KRASNIQI – Faleminderit z. kryesues. Unë po kërkoj falje prej deputetëve e kam një kërkesë. Jam konsultuar paraprakisht me kryetarin e parlamentit, si grup parlamentar me kryetarin e grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe kërkojmë që seanca e nesërme të shtyhet, të fillojë në orën 16,00 arsyeja është që disa anëtarë të grupit parlamentar dhe kryetari i partisë dhe anëtari i Grupit Negociator mungon, do të thotë s'ka mundësi me ardhur para orës 16,00. Lus që të keni mirëkuptim që kjo kërkesë jona të merret parasysh.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Mendoj që nga diskutimet që janë bërë më duket është një farë marrëveshje për të shtyrë nesër në orën 16,00 kemi biseduar, me qenë se ideja është të jenë të gjithë anëtarët e Grupit Negociator dhe të jenë sa më shumë në Parlament. Mendoj që duhet të kihet mirëkuptim në qoftë se duam, në qoftë se jo...

Z. Hamiti e ka kërkuar fjalën.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Unë më së pari desha t' ju pyes a është shterrë rendi i ditës së sotëm, atëherë unë nuk e kuptoj pse hyn kjo tash kështu. Proceduralisht unë po bëj pyetje procedurale, nëse është shterrë atëherë kam çka të bisedoj edhe për këtë, nëse ne jemi duke punuar me rendin e ditës, ju kisha lutë shumë të vazhdojmë me rend dite dhe të mbërrijmë në fund.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Jo nuk është shterrë .Z. Krasniqi e kërkoi fjalën ja dhashë ai propozoi dhe tani mbetën. Po vazhdojmë. Ju faleminderit.

Në vazhdim është

***9. Debati për tre qytetarët që akuzohen në Gjyqin e Hagës sipas kërkesës së një grupi të deputetëve të Kuvendit e bartur nga seanca e 26 janarit 2007.***

Në pajtim me rregullën 6.5 të Rregullores së punës së Kuvendit deputeti Nait Hasani me përkrahje të pesë deputetëve të tjerë të Kuvendi ka bërë kërkesë që Kuvendi të debatojë lidhur me 3 qytetarë të Kosovës të akuzuar në Gjykatën e Hagës.

Mocioni u është shpërndarë të gjithë deputetëve ,prandaj sipas radhitjes fjala i takon propozuesit të mocionit ,deputetit Nait Hasani.

DEPUTETI NAIT HASANI – I nderuari kryesues, të nderuar kolegë deputetë. Që të dal të flas këtu para jush më ka shty një rast i tillë, një analogji mjaft ose jo e rastësishme pikërisht data e gjykimit në Hagë 5 marsi, që është datë e familjes Jasharajve. Datë e

luftës për çlirimin e Kosovës dhe datë pikërisht për mbajtjen e seancës gjyqësore në Tribunalin e Hagës.

Po për të folë para jush më shtyri ndjenja e fuqishme njerëzore dhe një ndjenjë krenarie, pra vlerat tona për këtë popull të lashtë krenar. Ky popull ka vuajtur shumë dhe pjesëtarët e shumtë të këtij kanë kaluar nëpër kazamatet të **kravevinave** të komunizmit të Titos, të Rankoviçit, të Milosheviçit etj. Pra, në epokat e monarkive, të totalitarizmit kanë vuajtur kanë mbajtur burgje, janë sakrifikuar me familje për çlirimin kombëtar, për liri, barazi, demokraci.

Ky popull dhe bijtë e tij, të organizuar në luftën e lavdishme çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me të cilën krijuan dhe aleanca me fuqi të mëdha dhe me Amerikën. Kjo luftë çlirimtare e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës krijoi aleancë dhe me NATO-në në mbrojtje të vlerave njerëzore të lirisë, barazisë, demokracisë, pra në mbrojtje të lirisë qytetare si e drejtë e patjetërsueshme. Ushtria Çlirimtare e Kosovës me luftën e saj të drejtë krijoi vlera të larta njerëzore e politike. Në mbrojtje të lirisë e civilizimit njerëzor evropian në qendër të Ballkanit, nga barbaria e makinerisë policore e ushtarake të Serbisë dhe nga regjimi i Milosheviçit, makineri ushtarake e policore që kishte shkatërruar që më parë qindra e mijëra shtëpi dhe kishte vrarë mbi 200 mijë njerëz civilë të pafajshëm në Bosnje dhe Kroaci.

Një makineri të tillë po përgatitej dhe në Kosovë, por në mbrojtje të këtij populli nga kjo makineri ushtarake e policore u organizuan djemtë tanë në luftë çlirimtare për liri të cilën e udhëhoqi Ushtria Çlirimtare e Kosovës e cila i siguroi në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar e Aleancën Veri Atlantike, fitoren mbi Serbinë raciste dhe xhelatin e Ballkanit Milosheviçin.

Pra, për të mos mbajtur këtu para jush histori të gjatë se si erdhëm deri këtu unë mendoj që se secili nga ju e keni të qartë se pa luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe pa intervenimin e NATO-së as ne, an unë, e askush nga ju nuk do të ishte në këtë Kuvend legjislativ. Pra, as kjo Qeveri që e qeverisë Kosovën që për momentin nuk gjendet këtu te ne, në mundësitë e saj të mira apo të këqija nuk do të ishte këtu, as presidenti nuk do të ishte këtu, po falë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të NATO-së dhe vlerave njerëzore që krijuan ato. ne mbajmë seanca e qeverisim Kosovën nga ky Kuvend.

Po ata që krijuan vlera njerëzore dhe ata që na mundësuan të jemi këtu në këtë sallë, disa prej tyre sot nuk gjenden në familjet e tyre, nuk gjenden as në Kosovë, ata që kryen vlera janë sot në burgun e Shevingenit në Hagë, ata janë katër atje nga Kosova, jo për çështje personale që kanë bërë pas lufte. ndonjë vepër tjetër, po pikërisht për këto vlera të patjetërsueshme njerëzore që krijuan në kohën e luftës për ata sot vuajnë burgun në burgun e Hagës padrejtësisht nën akuzat me marifete të Serbisë. Pra, kjo është një precedencë për ne të bëjmë shire. Ata janë atje çlirimtarët e Kosovës, djemtë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, drejtues të kësaj lufte të lavdishme, Lah Ibrahimaj, Idriz Balaj, Hajradin Balaj dhe ish- kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj, i cili është në mbrojtje në liri

Ata janë në burgun e Shevingenit pa drejtësisht ky u fundit në mbrojtje në liri. Ne kemi deklaruar se jemi për bashkëpunim me Gjykatën e Hagës. Pra ata janë në burgje për të drejtat tona, për lirinë tonë, për jetën tonë, ata janë atje për mbrojtjen e vlerave tona njerëzore e politike. Prandaj, ata kanë nevojë sot më shumë se dje në luftë më shumë se kurrë për neve sot. Për përkujdesin tonë institucional, për dorën tonë mbrojtëse, për ndihmën tonë e prej shtetit të tyre. ata tre janë Lah Ibrahimaj, Idriz Balaj dhe Hajredin Balaj janë të vetmuar pa përkujdesje institucionale ose vetëm raste sociale në përkujdesje të familjeve të tyre atje, kurse ne si Kuvend i Kosovës u kemi borxh moral politik që atyre atje t'ua kthejmë dinjitetin qytetar e shpresën të ruajmë krenarinë për luftën çlirimtare që e bënë për ne për brezat për fëmijët tanë. Ne dimë se ata janë atje të pafajshëm siç ishin edhe Fatmir Limaj me Isak Musliu. Unë besoj fortë se edhe këta janë dhe do të dalin të pafajshëm por këtë pafajësi ata në sistemet ndërkombëtare legjislative në Gjykatën e Hagës mund ta bëjnë suksesshëm, ta mbrojnë Kosovën me ndihmën tonë, me mbështetjen tonë morale politike e financiare. Në mbrojtjen e vlerave tona çlirimtare dhe kombëtare nuk bëhet në Gjykatën Ndërkombëtare në Hagë pa mbështetjen tonë dhe këtë ne duhet ta bëjmë sot ,sepse ne bëjmë për këtë liri për lirinë tonë, kurse ta dini të nderuar deputetë Serbia po financon për mbrojtjen e kriminelëve të luftës dhe të krimeve monstruoze që kanë bërë dhe po financon për të na akuzuar neve e luftën tonë të shenjtë çlirimtare.

Pra, në Gjykatën e Hagës Serbia e mbrojtje edhe kriminelin e luftës Milosheviq që luftat e tij e tmerruan botën dhe morën qindra e mijëra jetë njerëzve të pafajshëm dhe kjo Serbi që në këto zgjedhje fituan radikalët e Sheshelit e varrosen kriminelin Milosheviq ..... Ndërsa ne çlirimtarët tani nuk kemi guxim qytetar t'i mbështesim, t' u sigurojmë mbrojtje ligjore vlerave tona kombëtare në Hagë në sistemin e drejtësisë ndërkombëtare.

Prandaj, unë kërkoj nga ju, nga ky Parlament të miratojë një deklaratë që do ta autorizojë Qeverinë në mbështetje morale politike të të akuzuarve në Hagë të Lah Ibrahimaj, Idriz Balaj, Hajredin Balaj dhe ish- kryeministrit Ramush Haradinaj, në mbrojtje ligjore, ndihmë financiare për familjet e tyre në Kosovë dhe për ata atyre në burgun e Hagës. Këtë e them se këto mundësi mbështetësi i ka marrë dhe i mbështesim qytetarët e tyre dhe shtetet që i kanë të akuzuarit e tyre në Hagë si Kroacia e Bosnja dhe Serbia për të akuzuarit e tyre. Veç e çeli një ultra nationalist serb në depozitën e tij bankare në burgun e Shevingenit në Hagë ka mbi 20 mijë euro në depozitë për nevojat personale. Kurse kryekrimineli i Ballkanit Milosheviqi kishte në depozitën e tij kur kam **qenë në vizitë** 70 mijë euro për nevojat personale. Ndërsa të akuzuarit tanë shokët tanë, djemtë tanë, luftëtarët e çlirimtarët tanë në depozitat e tyre nuk kanë as edhe 100 euro. Pra as për duhan, për ata, ne këtë gjendje të rëndë mbahen, e mbajnë veten nuk jepen dhe kanë moralin shqiptar, njerëzor, politik lirishtetëror. Por ne që jemi pjesë e asaj lufte të përbashkët ku do të jemi nesër pas përfundimit të gjyqimit dhe për të mos na gjykuar historia . duhet të veprojmë sot o kurrë në minutat e fundit të japim kontributin tonë secili sado të vogël e modest në çështjen tonë të madhe në vlerat tona të lashta njerëzore, t'u dalim në ndihmë këtyre djemve të së ardhmes sonë.

Në fund do t'ju kujtoj,të nderuar deputetë,një mbrojtje dhe një fitore në Gjykatën e Francës që e pat bërë dhe Avni Rustemi më 1921. Që atë e patën mbështet të gjithë

qytetarët e qytetit të Shqipërisë etnike si Prizreni e Gjirokastra, Vlora e Shkodra, Berati e Shkupi, Prishtina e Mitrovica, Gjakova e Peja, Kumanova dhe Ohri, me telegramet e tyre mbështetje financiare në mbrojtje të Avniut .Pat shkruar edhe shqiptari i madh i kohës Aleksandër Mojsiu . Mërgata nga diaspora e Amerika, pra e tërë bota intelektuale fshatare ishte me Avniun.

Prandaj, në këto rrethana nuk na duhet asgjë më shumë se sa të vëmë ndërgjegjen tonë në peshojë dhe të mbrojmë vlerat tona kombëtare liridashëse që sot ato vlera janë të përmbledhura në djemtë dhe vëllezërit tanë që gjenden në burgun e Shevingenit në Hagë o sot o kurrë ne nuk duhet të lejojmë që të na dënojnë e të na shpallin kriminelë për qejfe politike të Serbisë, sepse një luftë çlirimtare e kombëtare do të shpallet kriminale.

Prandaj, në mbrojtje të vlerave tona e dinjitetit tonë njerëzor e kombëtar ju bëjë thirrje të nderuar deputetë në mbrojtje të të ardhmes sonë të ndritur lirinë tonë politike.

Në propozim të kësaj kam një deklaratë Kuvendit të Kosovës i propozoj deklaratë që ta obligoj Qeverinë dhe të marrë një vendim që ta bëjë zbatimin. Kuvendi i Kosovës është deklaruar për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës në mbrojtje të të drejtave njerëzore të njeriut në bazë të kartës të Kombeve të Bashkuara dhe konventës së Gjenevës në mbrojtje të vlerave njerëzore fetare, racore, etnike e politike. Në krijimin e kushteve të të akuzuarve në Gjykatën e Hagës për mbrojtje të drejtë ligjore dhe demokratike të tyre. Në këtë qëllim Kuvendi i Kosovës e obligon Qeverinë që të krijoj në bazë të kompetencave të saj zbatimin e kësaj deklarate dhe hyrjen në fuqi menjëherë të pikave të saj. Në mbrojtje të vlerave njerëzore dhe politike të gjakut të dëshmorëve sakrificës sublime e biblike të popullit tonë nxjerrë

## DEKLARATË

Në mbështetje të akuzuarve nga Tribunali i Hagës si vijon: asistencë ligjore dhe juridike të stafit të avokateve, përkthyes 1, ndihmës ligjor 3, hetues të mbrojtjes 2, shpenzimet e transportit në shumën mujore gjithsej 18 mijë euro për ta.

2. Vizitën e akuzuarve shqiptarë në burgun e Shevingenit në Hagë të një grupi të deputeteve dhe ministrit të Drejtësisë.

3. Ndihmë mujore të akuzuarve nga 1000 euro për shpenzime ditore.

4. Në mbështetje familjes së ngushtë të tyre në të holla për të mos qenë në raste sociale, sepse ata duke qenë jo afër familjeve të tyre kanë mbetë raste sociale. të kujdesen njerëz me forma të ndryshme dhe për vizitën e burgut të Hagës në një shumë vjetore që kish me qenë për ta 100 mijë euro. Mbrojtja e drejtë e tyre atje dhe dalja fitues nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës janë një vlerë e madhe e përbashkët morale, politike e gjithë qytetarëve të Kosovës. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Deputetja Gjylnase Sylja e ka kërkuar fjalën.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLJA – Faleminderit. I nderuari z. kryesues të nderuar deputetë. Ne jemi përcaktuar qartë për të shikuar kah e ardhmja, por nuk duhet të harrojmë të kaluarën tonë të dhimbshme ,sepse duke kujtuar ne kujdesemi që të sigurojmë sa ajo nuk do të përsëritet më. Nuk duhet harruar sakrificat dhe mundin e madh të njerëzve të Kosovës në shërbim të atdheut. Lufta e tmerrshme në Kosovë ngjau vetëm tetë vite më parë. Vuajtjet dhe dhembja ishin të mëdha, u vranë u masakruan gra, burra, fëmijë, u dogjën shtëpitë, u dhunuan femrat u grabitën njerëzit që as sot e kësaj dite nuk u gjetën.

Në këtë kohë të vështirë, atëherë kur i duheshin Kosovës dhe popullit ishin ushtarë të UÇK-ës që mbrojtën lirinë dhe jetërat tona dhe na kthyen dinjitetin. Nuk ishte e lehtë lufta me armikun brutal dhe shumë herë më të armatosur. Guximi sakrificë ,përkushtimi i shprehur gjatë luftës për interesin në të mirë të Kosovës i shquante luftëtarët e UÇK-ës.

Lufta e UÇK-ës ishte e drejtë, promovimi i lirisë dhe ndërtimi i shoqërisë vërtet demokratike ,të drejtë paqësore dhe prosperuese ishte qëllimi. Kjo e ka inspiruar ushtarin e UÇK-ës. Po ashtu nuk e harrojmë dhe gjithmonë do ta kujtojmë intervenimin e NATO-së në shpëtimin e jetërave tona të udhëhequr nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët.

I nderuari kryesues,

Ne sot po diskutojmë këtu pikërisht falë sakrificës së tyre. Sot e kemi rastin e mirë që duke i mbështetur me mjetet e nevojshme ushtarët e UÇK-ës që ndodhen në procesin e Hagës të dëshmojmë se çmojmë kontributin e njerëzve të Kosovës për liri dhe vlerat e lirisë. Ata i kanë merituar mirënjohjen, respektin dhe përkujdesin tonë.

Prandaj Grupi Parlamentar i Aleancës mirëpret dhe e mbështet iniciativën e deputetit Nait Hasani dhe të deputetëve të tjerë për të ndihmuar në mënyrë institucionale katër luftëtarët e UÇK-ës në procesin e Hagës. Ne besojmë në pafajësinë e tyre. E vërteta duhet të thuhet, e kemi mirëpritur dëshmimin e pafajësisë dhe lirimin e Fatmir Limaj e të Isak Musliut.

Shpresojmë se në shkallën e dytë të gjykimit lirohet Haradin Balaj, shpresojmë gjithashtu se Haga do ta marrë parasysh gjendjen e tij të rëndë shëndetësore dhe familjare. Mendojmë se do të ishte në natyrën e obligimeve të kërkohet që z. Balaj shërbimin ta përjetojë në Kosovë në pritje të vendimit të shkallës së dytë.

I propozojmë Qeverisë që të ndajë fonde që të mbulojë këshillimet juridike dhe vizitat e familjarëve. Mendoj që është gabim që Haga i ka marrë këta njerëz dhe kjo do të vërtetohet ashtu siç u vërtetua në rastin Limaj dhe Musliu. Megjithatë ne duam të fitojë drejtësia, ne do të vazhdojmë bashkëpunimin në mënyrë të përgjegjshme me ligjin ndërkombëtar dhe me gjykatën ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,



Më lejoni ta përfundoj fjalën time me citatin nga deklarata e ish -kryeministrit Haradinaj pas dorëheqjes së tij nga posti i kryeministrit. Kjo është reflektim i karakterit të luftëtarit dhe të liderit të jashtëzakonshëm i cili vuri interesin e popullit para interesit të vet.

Unë jam një njeri i Kosovës dhe me dëshirë sakrifikoj për vendin tim, prandaj e pranoj këtë barrë ,por në të njëjtën kohë kërkoj edhe nga ju që ta pranoni këtë fakt. Kërkoj nga ju të gjithë që të pranoni diçka që është gati e pamundshme për t'u pranuar, por bëjeni këtë për t'u bërë nder vendit dhe kombit.

Kërkoj nga ju që të mendoni për interesin madhor të vendit. Bashkësia ndërkombëtare e ka bërë një gabim të madh kur e ka krijuar një tribunal i cili i trajton luftëtarët e lirisë njësoj si agresorët që shkatërruan popuj të tërë dhe e kthyen rajonin në gërmadha.

Dëshiroj të besoj se ka qenë një gabim pa dashje, dëshiroj të besoj se ata nuk kanë dashur që kjo të ndodhë. E di që shumica prej tyre do të jenë shokuar po aq sa edhe unë dhe po aq sa jeni edhe ju. Kjo që është përgatitur buron nga gënjeshttrat e përgatitura në Beograd dhe nga pazarllëqet që disa i kanë bërë me qeverinë e Serbisë për t'i ekstraduar kriminelët serbë. Ky është një gabim i bërë nga disa njerëz që nuk e dinë fare se çka ka ndodhur në Kosovë dhe që nuk duan t'ia dinë se çfarë do të ndodhë këtu në të ardhmen. Sidoqoftë unë e di se nuk jam përgjegjës për ato që akuzohem dhe po ashtu e di se edhe gjykata do ta vërtetojë këtë.

Ftoj deputetët që të mbështesin deklaratën e propozuar nga deputeti Hasani dhe deputetët e tjerë. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Faleminderit. për fjalë është paraqitur deputeti Emrush Xhemajli.

**DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI** – I nderuari z. kryesues ,zonja dhe zotërinj deputetë dhe ju të pranishëm. E mbështes propozimin dhe diskutimin edhe të deputetit Nait Hasani dhe deputetëve të tjerë që Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria të ndihmojnë në formë institucionale ish- kryeministrin z. Ramush Haradinaj Lah Ibrahimaj, Idriz Balën dhe Haradin Balën pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në momentet më të vështira për Kosovën ata i dolën zot vendit. Ne duhet të jemi gjithë krenarë që jemi në anën e lirisë bashkë me qytetarët e Kosovës që janë thirrur pa nevojë në Hagë me një aktakuzë të cilën besoj e keni lexuar të gjithë që është e motivuar politikisht Kosova duhet të jetë mirënjohese dhe të interesohet për ta përmes institucioneve tona dhe konkretisht ju thërras edhe një herë që t'i përkrahim propozimet.

Që një delegacion i deputetëve të Kuvendit të Kosovës të shkojë të bëjë vizitë në Hagë te Lahi Ibrahimaj, Idriz Balaj dhe Haradin Balaj, si dhe këtu të formohet një delegacion që do të vizitojë z. Ramush Haradinaj këtu në Kosovë.

Dhe e dyta, ashtu siç i prezantoi detajet deputeti Nait Hasani shpenzimet dhe detyrimet që dalin nga kjo kërkesë të mbulohen nga buxheti i Kosovës. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Të paraqitur të tjerë për diskutua për këtë çështje Nazim Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Faleminderit z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë. Është shumë e vështirë të diskutohet për këtë pikë të rendit të ditës për më shumë se një arsye. Dhe do të përpiqem t'i reshtoja arsyet.

Arsyeja e parë është se të gjitha ato fjalë që i tha Naiti e pas tij Emrushit qëndrojnë. Por nuk qëndrojnë vetëm për këta të tre apo katër, nuk e di sa janë këtu të rreshtuar ,sepse kërkesa kur është bërë në Kryesi të Kuvendit ka ardhur për të debatuar për tre luftëtarët e UÇK-ës që ndodhen në Hagë. Tash na dolën që janë katër. Pra .të gjitha qëndrojnë po qëndrojnë për të gjithë luftëtarët e UÇK-ës dhe jo vetëm për ata edhe të tjerët para tyre të cilët sakrifikuan për ditën ,që ne po shpresojmë shumë shpejtë do të vijë. Dhe pikërisht duhet të ndalem në këtë moment, te momenti i ditës të cilën shumë shpejtë do të hymë. Edhe .... që ndërlihd miratimi i një deklarate të Kuvendit të Kosovës sot në këtë çast lidhur me këtë problematikë me procesin nëpër të cilin po kalon Kosova sot. Ky është, një aspekt një racion, të cilin e kisha pas dëshirë ta miratoni dhe ta analizoni.

Ana tjetër, aspekti tjetër që duhet ta analizoj është se ne si shoqëri ju përgëzoj juve deputetëve të nënshkruar këtu: Xhemajli, Bislimi, Buja, Hyseni, Berisha, Shala, që të gjithë janë deputetë nga PDK-ja. Pra është Grupi Parlamentar i PDK-ës. **Pas kësaj nisme vetëm një grup i deputetëve apo nëngrup parlamentar i PDK-ës është ... kësaj nisme**, është shumë me rëndësi, kisha pas dëshirë po ashtu të kemi këtu qëndrim edhe nga grupi më i madh parlamentar në Kuvend të Kosovës, nga Lidhja Demokratike e Kosovës që është partia më e madhe që është motori i të gjitha lëvizjeve dhe sukseseve në Kosovë në 17- vjetshin e fundit.

Prandaj duke pasur parasysh relacionin e ndërtuar pra, momentin nëpër të cilën po kalojmë, duke pasur parasysh situatën në të cilën ndodhemi, duke pasë parasysh procesin **a kemi ..... të cilat do të** mund ta cenojnë procesin nëpër të cilin po kalojmë në qoftë se ne e miratojmë këtë deklaratë.

Tash do të ndalem edhe në një moment tjetër lidhur me këtë deklaratë. Kjo deklaratë që është pru këtu nuk është obligative, deklaratat nuk obligojnë, vendimet obligojnë, në qoftë se jemi ne e marrim vendim. Në instancë më të lehtë të aprovueshme mund ta marrim një rekomandim, siç na ka ndodhur edhe herëve të tjera të miratojmë rekomandime në Kuvend të Kosovës lidhur me çështje të caktuara.P.sh. në vitin 2005 diku në verë të vitit 2005 e kemi marrë një rekomandim për të paguar 6 milion euro pensionistëve të Kosovës dhe kurrë Qeveria e Kosovës nuk e ka bërë asnjë hap të vetëm në drejtim të realizimit të atij rekomandimi nga Kuvendi i Kosovës. Deklarata hiq nuk është obligative, hiq, ama bash hiq.

Prandaj ju lutem të nderuar kolegë deputetë ju kisha sugjeruar që ta tërhiqni këtë dokument për ta ripunuar, për ta rianalizuar dhe për ta sjellë në mënyrë më të mirë të mundshme që edhe në qoftë se e miratojmë ne në Kuvend ta miratojmë me forcën e plotë e mos të tallemi vazhdimisht. Po insistoj të mos tallemi sepse të gjitha këto për mendimin tim janë tallje, tallje me njerëzit që kanë sakrifikuar për këtë vend, tallje me njerëzit që po sakrifikojnë sot duke qëndruar jashtë vendit me mundin dhe me djersën e vet, të jemi më seriozë, të jemi më të përqendruar.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Faleminderit. fjalën e ka Alush Gashi.

**DEPUTETI ALUSH GASHI** – I nderuari z. kryesues. Ne kemi mbështet që kjo çështje të jetë në rendin e ditës duke njoftur për rëndësinë që ka për shoqërinë e për vendit tonë në përgjithësi.

Si Grup parlamentar ne konsiderojmë të pafajshëm deri në argumentim të fajësisë. Në vitet e shkuara ,por edhe tash i kemi mbështetur të gjitha iniciativat, qoftë për hartimin e deklaratave apo të rezolutave lidhur me Tribunalin e Hagës, njëjtë kemi vepruar si grup parlamentar kur është akuzuar z. Fatmir Limaj ,të njëjtën gjë disa herë e kemi përsërit gjatë atij procesi ,por edhe kemi ripërtëritur gjatë ngritjes së dyshimit për akuzë për z. Hardinaj.

Ne nuk kemi në mesin tonë dyshim në mbështetje pse i konsiderojmë të pafajshëm deri në argumentimin e së kundërtës. Për miratim të ndonjë vendimi apo për hedhjen në votë të një çështjeje, mendoj se deputetët meritojnë të jenë të informuar me kohë me tekstin që t’u shpërndahet grupeve parlamentare e të komunikojnë lidhur me këtë çështje e cila i bashkon qytetarët e Kosovës jo të ketë përpjekje të ndarjes së tyre në mënyrë shumë artificiale. Andaj propozimi im është që kjo çështje sot të mos hidhet në votim përveç mbështetjes të cilët na i kemi dhënë në kontunitet dhe të shikohet mundësia se cilat janë mundësitë ligjore në kuadër të realitetit ekzistues që Qeveria të del ndihmë si për familje apo edhe për të dyshuarit.

Andaj duke i dhënë mbështetje përkushtimit që ne të përkujdesemi në kuadër të mundësive ligjore lus që çështjen të mos e hedhin në votim, deklarata, teksti për deklaratë të regjistrohët të shpërndahet grupeve parlamentare të marrin të gjithë deputetët dhe në këtë çështje të jemi së bashku. Mos të jetë një çështje vetëm deklarative momentit. Andaj e përsëris që propozim deklaratën t’ia shpërndani gjithë deputetëve dhe nëse ka nevojë pas marrjes së përgjigjes nga ana e Qeverisë se cilat janë mundësitë reale ligjore që t’u ndalet ndihmë kësaj çështje, duke i përkujtuar se ne si Kuvend e kemi miratuar një ligj për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës. Faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI** – Faleminderit z. Gashi. Fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni.

**DEPUTETI HAJREDIN HYSENI** – Z. kryesues, të nderuar deputetë. Kujdesi ndaj qytetarëve të vendit është vetëdija shtetërore e cila manifestohet nga vendet të cilat

udhëhiqen nga primet se çdo qytetar është përfaqësuesi i vendit dhe atij duhet dalë në ndihmë varësisht nga nevoja dhe kërkesat që janë në përputhje me këto parime.

Në qoftë se shikojmë se qytetarët që sot momentalisht ndodhen në Gjykatën e Hagës si të akuzuar dhe kujdesin që kanë institucionet e Kosovës për ta, mund të konstatojmë se ne nuk kryejmë obligime ndaj qytetarëve tanë. Andaj, atyre që vërtet kontribuuan në krijimin e institucioneve dhe të tashmes së Kosovës dhe sot ndodhen si të dyshuar në gjykatën e Hagës e dihet parimi i drejtësisë se i dyshuari nuk është fajtor derisa ai të gjykohet. Mendoj se është mirë që institucionet e Kosovës, konkretisht Qeveria e Kosovës të merr mbi vete kujdesin ndaj qytetarëve të saj ,të afrojë mbrojtjen e tyre, ndërsa në praktikën e deritashme kjo nuk ka ndodhur. Mendoj se ka qenë një papërgjegjësi e tyre ,sepse këta qytetarë akuzohen për një çështje të përgjithshme dhe ka interesa të balancimeve të rrezikshme për Kosovën dhe për të ardhmen e saj.

Të nderuar deputetë.

Kosova do të jetë shtet i nderuar dhe i respektuar edhe nga vendet e tjera vetëm kur do të mbrojmë të drejtat e qytetarëve të vet, kur në bazamentin e angazhimeve dhe të sjelljeve të institucioneve të saj do të ketë qytetarin e Kosovës dhe do t'i kryejë obligimet e veta ndaj tyre. Besoj se është koha që ky Parlament, Qeveria e dalë nga ky Parlament i dalë nga vota e qytetarëve të marrë këto obligime dhe t'i kryejë ato në raport me këta qytetarë të Kosovës dhe në raport me familjet e tyre.

Ne me punën tonë dhe sjelljen tonë duhet t'i përcjellim mesazhin e besimit tonë se këta qytetarë janë të pafajshëm dhe duhet t'u ofrohet mbrojtja institucionale pa bërë ndonjë klasifikim mes tyre, që vërtet edhe këta qytetarë të mos e ndiejnë vetminë e deritashme të harresës së institucioneve dhe të Kosovës. Ju faleminderit.

**KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit z. Hyseni. Fjalën e ka deputeti Berat Luzha.**

**DEPUTETI BERAT LUZHA – Z. kryeses, të nderuar kolegë deputetë.** Edhe unë pajtohem plotësisht që ata që janë të akuzuar në Gjykatën e Hagës duhet të mbrohen institucionalisht nga Qeveria e Kosovës dhe ata meritojnë ndihmë institucionale. Por unë dua të shtoj edhe se nuk janë vetëm ata të cilët janë të akuzuar për krime lufte padrejtësisht, pa faj, por ka edhe të burgosur në Kosovë të cilët vuajnë gjithashtu nëpër burgje, janë të akuzuar dhe janë të dënuar pa fakte të cilët janë gjithashtu në gjendje të vështirë ekonomike të familjeve të tyre edhe shëndetësore dhe gëzojnë një trajtim jo të drejtë dhe një trajtim rigoroz sikur ata të ishin kriminel të luftës që kanë bërë krime masive apo masakra që ato fare nuk qëndrojnë te pjesa e luftës sonë, e luftës së drejtë të popullit tonë.

Procedura e Grupit të Kaçanikut, e kam fjalën aty janë tre persona të cilët janë gjykuar në shkallën e parë, por tash është ngri procedura ndaj tyre për shkak se gjykata nuk ka fakte të mjaftueshme për ta vazhduar me shkallën e dytë dhe ata janë tash peng të gjyqtarëve ndërkombëtarë ,të cilët e kanë lënë në harresë lëndën e tyre.

Kërkoj që bashkë me të akuzuarit në Hagë të trajtohen nga Qeveria edhe të akuzuarit e luftës këtu në Kosovë ,të cilët padrejtësisht mbahen në burgje dhe dënohen. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Tjerë të paraqitur nuk ka. Ka propozime që kanë ardhur nga propozuesi dhe propozimet që kanë dalë nga grupet parlamentare. Por para se të propozoj se si të shkojë më tutje, mendoj që ne të gjithë qytetarët e Kosovës, të gjitha institucionet e Kosovës, duhet të jenë krenarë që djemtë e Kosovës kanë luftuar për lirinë e vet dhe për gatishmërinë e tyre konform vendimeve që e kanë bërë edhe institucionet e Kosovës për t’iu përgjigjur drejtësisë për akuzat të cilat besoj, nuk qëndrojnë dhe do të jenë të pastruar nga këto akuza.

Unë mendoj që shkuarja vullnetare, gatishmëria për t’u ballafaquar me drejtësinë, gatishmëria për t’u ballafaquar me Gjykatën Ndërkombëtare të Hagës, gatishmëria për t’u ballafaquar edhe me gjykatat vendore ka ndikuar pozitivisht në vlerësimet që bashkësia ndërkombëtare ka dhënë për Kosovën, dhe nuk e ka barazuar me Serbinë e cila heziton që t’i dorëzojë ata të cilët vërtet janë të akuzuar dhe akuzat kundër tyre janë të argumentuara.

Prandaj, unë jam plotësisht dakord me propozimet e dhëna, por këtu ka implikime buxhetore, ka çështje të cilat edhe në qoftë se i votojmë ne nuk jam i sigurt që mund të realizohen konform ligjeve funksionale në Kosovë. Prandaj, mendoj që deklarata e propozuar dhe kërkesat në këtë deklaratë të analizohen nga ekspertët e të gjitha grupeve parlamentare, sepse unë besoj se askush nuk ka kundër që t’u shkohet në ndihmë djemve tonë dhe pasi që të analizohet edhe në Komisionin për Buxhet i cili mendoj do të duhej të jepte një vlerësim rreth mundësisë apo jo që të merr vendim Kuvendi i Kosovës, rreth kësaj dhe harmonizimit me Ministrinë e Financave dhe ligji në fuqi. Të shohim a është e mundur të marrim vendim apo jo. Prandaj e përshëndes anën formale, por njëkohësisht besoj që kërkesa për të mos u futur në votim dhe që nesër që të mos kemi mundësi me realizuar këtë pjesën e kërkesave financiare është pak problematike. Unë mendoj deri në seancën e ardhshme propozoj që të shtyhet marrja e vendimit për këtë çështje. Ju faleminderit, propozuesi ka të drejtë të shprehë mendimin e vet.

DEPUTETI NAIT HASANI - Ju faleminderit kryesues edhe unë pajtohem që grupet parlamentare ta marrin në shqyrtim këtë që në seancën e ardhshme të marrim një vendim dhe ta realizojmë këtë kërkesë.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Hasani për mirëkuptim. Po shkojmë më tutje me pikën e 10 të rendit të ditës.

## **10. Shqyrtimi i mocionit të shtatë deputetëve për shpalljen e 27 prillit – Ditë e pagjeturve në Kosovë**

Në pajtim me rregulloren 6.5 dhe 22.5 të Rregullores së punës së Kuvendit shtatë deputetë të Kuvendit të Kosovës kanë bërë kërkesë që Kuvendi me një vendim të përkohshëm të shpallë 27 prillin Ditë e të pagjeturve në Kosovë. Mocioni i është

shpërndarë të gjithë deputetëve. Ftojë propozuesin e mocionit deputetin Kamber Kamberin ta merr fjalën lidhur me propozimin që i ka bërë.

DEPUTETI KAMBER KAMBERI- Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar kolegë deputetë.

Duke u bazuar në rregullin 6.5. të Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës kërkesës së paraqitur paraprakisht me datën 3 prill 2006, propozimit për mocion të mbështetur nga një grup i deputetëve të datës 26 janar 2007, paraqes të nderuar deputetë para jush për miratim kërkesën për shpalljen e 27 prillit Ditë të të pagjeturve të Kosovës:

Arsyetim: Lufta e fundit në Kosovë i nxitur dhe i shkaktuar nga regjimi Serb shkaktojë shumë dëme, vrasje, e krime nga më makabret. Mori shumë jeta njerëzish duke dalë jashtë çdo kodi moral, e njerëzor. Ky regjim për të fshehur krimin e bërë gjatë luftës së fundit në Kosovë varrosi në varreza masive, zhvarrosi të të vrarët e të masakruarit për ti marrë me vete, e për ti fshehur gjurmët e krimit nëpër Serbi duke i varrosur e zhvarrosur sa e sa herë.

Shumë nga të kidnapuarit. të keqtrajtuar e keqpërdorur nuk dihet se si përfunduan apo ku ju humbën gjurmët në Kosovë apo në Serbi. Ç’ eksperimente apo ç’ pazare mund të jenë bërë me këta njerëz. Gjatë luftës së fundit në Kosovë u vranë me mijëra ndërsa a qindra të tjerë u rrëmbyen dhe u zhdukën në Meje të Rrekës së keqe në Gjakovë, në Krushë, në Rahovec, Pejë, Deçan, Therandë, Drenicë, Llap, Has e në gjithë Kosovën. Nga të gjitha këto tragjedi të dhembshme masakra e 27 prillit të vitit 1999 e ndodhur në Meje të Rekës së Keqe është një nga masakrat më të mëdha në të cilën vetëm brenda një dite u vranë apo u zhdukën rreth 400 shqiptarë pa dallim moshe e gjinie.

Si do që të jetë një gjë është e qartë. Fati i shumë të rrëmbyerve e më pas të zhdukur në Kosovë, ndoshta nuk do të dihet kurrë, andaj, bazuar në rezolutën e Kuvendit të Kosovës datë 10 prill 2003 dhe deklaratën e Kuvendit për çështjen e pazgjidhur të pengjeve të luftës. të të rrëmbyerve dhe të pagjeturve të Kosovës. më 21 korrik 2005, duke e respektuar kërkesën e këshillit ndërfamiljarë të zhdukurve në Kosovë, bazuar në kërkesën e këshillit koordinues të asociacioneve të familjarëve të zhdukurve të Kosovës, duke ju referuar statutit dhe rregulloreve të këtyre shoqatave, duke mos bërë dallim përkatësie kombëtare, racore, e fetare apo periudhe kohore, duke respektuar marrëveshjen e mirëkuptimit të ndërsjellë me qëllim të shënimit me dinjitet dhe në përkujtim të të zhdukurve të solidarizimit shpirtëror me familjarët e tyre, propozoj:

Që Kuvendi i Kosovës me një vendim të përkohshëm deri në rregullim me ligj të shpallë 27 prillin- Ditë e të pagjeturve të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. deputetë. Sipas radhës deputeti Alush Gashi në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së.

DEPUTETI ALUSH GASHI – I nderuari z. kryesues. Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar fillimisht kërkesën e deputetit Kamberi dhe pas kërkesës së parë e cila është

refuzuar ,sepse s'i ka plotësuar kushtet sipas Rregullores së punës, e kemi mbështetur plotësisht kërkesën e deputetit Kamber së bashku me një numër tjetër deputetësh që sipas Rregullores së Punës së Kuvendit i plotëson kushtet për një propozim të tillë.

Ne si grup parlamentar e mbështesim këtë propozim dhe kërkojmë që kjo çështje të rregullohet sa më parë me ligj dhe mendoj se edhe si kërkesë edhe si vendim i përkohshëm mund të jetë një urdhërrëfyes që hartuesit e ligjit të punojnë intenzivisht që sa më parë kjo çështje të rregullohet me ligj. Ne do të votojmë për nëse na ftoni në votë. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së Ramë Buja.**

**DEPUTETI RAMË BUJA – Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar deputetë. Respektoj shumë atë që e ka bërë propozimin për këtë datë dhe mendoj që ky mocion i ofruar në Parlamentin e Kosovës i bën nder këtij Parlamenti në qoftë se e aprovon këtë gjë dhe respekt atyre që janë të zhdukur dhe që gjithsesi për këtë ndiejmë dhembje të gjithë.**

Prandaj, Grupi Parlamentar i PDK-së e mbështet këtë datë për me qenë një datë e shënuar për herë dhe natyrisht me respekt.

**KRYESUESI, XHAVIT HALITI –Ju faleminderit z. Buja. Në emër të Grupit Parlamentar për AAK zonja Gjylnaze Sylja.**

**DEPUTETJA GJYLNAZE SULA – Ju faleminderit z. kryesues. Edhe ne Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështesim kërkesën e deputetit Kamberi, por ne për ma tepër mbështesim edhe kërkesa të tjera të paraqitura nga këshilli organizativ i protestës që janë diku edhe pesë kërkesa të tjera. D.m.th. pos kësaj unë mendoj si Kuvend duhet të angazhohem edhe në kërkesat tjera të shtruara nga këshilli organizativ. Ju faleminderit.**

**KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Në emër të Grupit Parlamentar ORA, Teuta Sahatqija**

**DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Ju faleminderit z. kryesues. Dhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë nismë dhe mendojmë që është një nismë jashtëzakonisht e mirë për t'i kujtuar të pagjeturit e Kosovës. E dimë që lufta 98-99 ka qenë një luftë çnjerëzore, një luftë e cila nuk i ka respektuar rregullat e luftës dhe në të cilën civilët bile edhe gratë edhe fëmijët ishin në shënjestër. gjë e cila tregon atë karakterin gjenocidal të luftës.**

Rast tipik dhe shumë i rëndë është gjithashtu në mesin e shumë rasteve të tjera edhe rasti i Gjakovës e posaçërisht edhe rasti i Mejës që është një vërtetim i gjallë i këtij karakteri. Por mendojmë që kjo nismë do të duhej të jetë një nismë serioze dhe kjo çështje e cila aspak nuk është çështje e përkohshme ,por është një çështje shumë e rëndësishme dhe pa marrë parasysh sa vjet, sa dekada do të kalojnë kjo do të jetë përsëri një çështje e dhimbshme e cila nuk duhet assesi të harrohet.

Në qoftë se tash e aprovojmë këtë nismë ,atëherë do të kishim ardhur te disa çështje të cilat nuk janë të definuara, çështje më shumë teknike, sikur që është çështja se çfarë manifestimesh do të bëhen, si do të shënohet kjo ditë, a do të jenë flamujt në gjysmështize apo jo, a do të ketë edhe ditë pushimi, do të jenë, do të thotë çështje shumë teknike. Prandaj, për të mos marrë vendime disa herë për të qenë sa më seriozë dhe t'i trajtojmë në mënyrë serioze dhe të dinjitetshme këtë rast propozoj që kjo nismë të bartet në Kuvend dhe Kuvendi të organizojë komisionin adekuat të punohet ligji prej këtij Kuvendi që të mos ketë vonesa pasi me ligjin e diasporës e pamë çfarë vonesash ka që Kuvendi ta hartojë ligjin dhe në kohë sa më të shkurtër ta miratojë atë lig dhe kjo ditë të jetë ditë e cila do të shënohet në mënyrë zyrtare, jo në mënyrë të përkohshme. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – NË emër të grupit parlamentar 6+. Mahir Jagcilar.

DEPUTETI MAHIR YAGCILAR – Ne si grup 6+, Grupi Parlamentar plotësisht e mbështesim këtë iniciativë.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, për fjalë është paraqitur deputeti Gjergj Dedaj

DEPUTETI GJERGJ DEDAJ – Prej sa jam në këtë Parlament besoni që kam vërejtur se shumë po hymë në gjynah, ndoshta jo aq sa ka hy Serbia me këta njerëz. D.m.th. tu u munduar qoftë me përfituar partiakisht, qoftë individualisht mbi gjakun e njerëzve më të çmuar këtu. Kam respekt për deputetin Kamberi, sepse vijmë nga e njëjta zonë, lokalitet, por nuk e kuptoj së paku si koleg qysh nuk më ka njoftuar për këtë nismë kur dihet se pikërisht më 27 prill 1999 dhe mua personalisht kur e përmendët këtë datë d.m.th. më rrotullohet Kuvendi i Kosovës, së paku me më njoftuar për këtë nismë dhe me marrë mendimin tim si deputetë, si koleg, sepse po atë ditë i kam të humbur me dhjetëra të vrarë me dhjetëra anëtarë të familjes shumë prej tyre janë ende të zhdukur dhe tash unë dëgjojë, besoni as në postën e deputetit që e ka edhe çelësin e hekurt dhe e hap, gjithmonë nuk e kam gjetur këtë propozim, por shikoni, unë çka flas është ashtu, unë nuk jam hipokrit, sinqerisht ju them, d.m.th. unë thashë, unë e marr materialin në postë ajo nuk ka çelës, mundeni me shkuar me vërtetuar dhe unë nuk kam marrë materiale, sikurse nuk i kam disa herë ftesat se gjoja Vizneri më ka thirr e s'më ka thirrë, nuk më keni thirrur, ose thirrni një ditë përmasë, të jemi të qartë.

D.m.th. s'e kuptoj as atëherë pikërisht që është debatuar për ligjin për luftën dhe ju shumë deputetë këtu keni votuar që njerëzit që janë vrarë me 27 prill dhe gjithë andej Kosovës i keni trajtuar me ligj viktime, persona të vdekur gjatë luftës në Kosovë, që ka qenë skandaloze, ka qenë fyese për familjet e dëshmorëve dhe për gjakun që është derdhur për liri të Kosovës. Ky Kuvend i Kosovës e ka bërë një gjë të tillë. Dhe tash 27 prilli që është numerikisht sepse edhe kur është vrarë një njeri edhe në çdo zonë që janë vrarë 10 ose 5 është njësoj, sepse gjithë janë vrarë për Kosovën e jo për partitë politike të Kosovës as për interesa tona personale.



MË 27 prilli janë vrarë afro 400 shqiptarë dhe tash një farë mënyre ata nëse aprovohet kjo që me u shpallë dita e të zhdukurve .të të pagjeturve d.m.th. ata janë si persona të pagjetur dhe paskan humbur, personat që kanë vdekur gjatë luftës në Kosovë, kjo është katastrofale.

E 27 prilli duhet me qenë Dita e dëshmorëve të Kosovës, dita e martirëve të Kosovës, e nëse vazhdoni kështu, me trajtuar gjakun e dëshmorëve. Ju po i fyesi familjet tona, po i fyesi dëshmorët e Kosovës, po i fyesi martirët, sepse unë ma së pakti kam pas dëshirë edhe asnjë fushatë zgjedhore nuk kam dëshirë, asnjë votë me e marrë në emër të atij gjaku, se ai gjak nuk është derdhur për vota. Ai gjak është derdhur është për flamur ,për atdhe dhe për shtetin e Kosovës. Ka pasur plotë raste, nuk dua me i përmendur shumë se **iritohna** edhe më dhimben për çdo ditë e më shumë, kur në emër të atyre dhe të atij gjaku njerëzit kanë bërë gjithçka, madje edhe gjithçka. Kështu që është mirë kjo çështje të debatohet ma së pari në Kuvendin e Kosovës mirë, mos të marrim vendime të ngutshme.Edhe për rastin që e paraqiti deputeti Hasani që është shumë mirë i pranueshëm, mos të ngutemi ,sepse nuk do të na falë historia, nuk do të na falin as fëmijët jetimë që janë kah rriten në Kosovë pa asnjë përkujdesje , madje as abetare atje nga fshati im asnjë abetare askush qe tetë vite nuk ua ka dërguar, askush nga institucionet e Kosovës në fshatin tim që ka 80 banorë, 25 të vramë, të zhdukur ende asnjë institucion i Kosovës nuk e ka shkelur atë vend, e me i ndihmuar 100 fëmijë, domethënë të atyre shkollave përreth jetimëve që kanë mbetur pa prind, kështu që mos luani me gjakun tonë. E le të jetë hera e fundit që luani me gjakun tonë për interesa partiake. Ju faleminderit shumë.

**KRYESUESI, XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit z. Dedaj, për fjalë është paraqitur Sabri Hamiti.

**DEPUTETI SABRI HAMITI** – Kolegë të nderuar z. kryesues, natyrisht që unë pajtohem me propozimin që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së e bëri Alush Gashi dhe nuk kam ndonjë nuancim rreth kësaj. Unë kam dashur ta shfrytëzojë rastin kur bisedohet për këtë pikë ta bëjë një propozim para Kuvendit dhe ju do të shihni që edhe ky diskutim të sotëm e motivon shumë këtë propozim që do ta bëjë unë.

Këto janë tema të dhimbshme dhe njerëzit kur flasin qoftë edhe në institucione, bëhen shumë personal, kjo ngjallë edhe këtu në bisedime që bëjmë edhe një pikë më herët, edhe në këtë pikë këtu. Meqë jemi në një institucion shumë të lartë përfaqësues siç është Kuvendi i Kosovës, jemi të detyruar që të bëhemi sa më racional që të mundemi edhe sa më funksional që të mundemi. Unë e shfrytëzojë rastin e hapjes së bisedave për njerëzit e vrarë në Kosovë që Kuvendi ynë ta nxjerrë një ligj kundër gjenocidit, në mënyrë që, ne mënyrë institucionale t'i rregullojmë një herë e përgjithmonë gjërat, dhe pjesa tjetër tani ndërtohet si kujtesë si histori, si dëshmi, si vlerësim.

Ky vend ka nevojë edhe në kuptimi ne përcaktimit universal që ta hartojë një ligj kundër gjenocidit, dhe ma në fund edhe për shkak të gjenocidit ose përpjekjes së gjenocidit nëse e quajmë me formën pak më të butë që kanë ndodhur në Kosovë në fundin e shekullit të kaluar. Kjo për dy arsye. Një sepse, gjenocidi ka ndodhur, historia ka ndodhur, kurrkush

**nuk mund ta mohojë në kuptimin elementar po në të vërtetë ekzistojnë metoda politike të brendshme, ose të jashtme që kanë filluar ta bëjnë të fuqishëm negacionizmin që në kuptimin që flasë unë do të thotë haresë, thuhet harroni të kaluarën për shkak të ardhshmes. Kjo është frazë politike që funksionon edhe këtu prej nesh shumica kanë dëshirë e thonë këtë sepse duket e bukur, politikisht. **Ndërsa negacionizmi** harresa e gjenocidit është forma ma e lartë dhe ma e perfeksionuar e krimit. Forma superiore e krimit është të harrohet krimi. Siç është forma ma e përsosur e krimit, krimi që i humb gjurmët.**

Në Kosovë i kemi këto dy fenomene të provuara herën e fundit, krimin masiv që shkon kah gjenocidi se i mbyl 14 mijë veta dhe i shpërngul 800.000, në anën e tjetër fshehjen e krimit, që është shkalla e naltë e organizuar që të fshihen kufomat dhe këta njerëz që ne i quajmë të zhdukur dhe nga dhimbja familjare është prodhuar termi, të pagjetur, janë një pjesë e kësaj turme të njerëzve që i ka përfshirë gjenocidi. Pra, ky ligj ,që duhet të jetë me pak nene që unë afrohem me një grup të deputetëve ta hartomë vetë dhe në emër të deputetëve ta paraqesim .Do të krijonte një organ ,një strukturë të përgjegjshme qeveritare që t'ju përgjigjet këtyre dy kërkesave, një të evidentojë saktësisht viktimat e gjenocidit në Kosovë dhe mos të flitet se janë kaq ose kaq, unë edhe sot e dëgjova këtu se janë për afërsisht kaq. Është me të vërtetë e palejueshme që pas kaq viteve të flasim me shifra të përafërta. Çdonjëri është një njeri, nuk është statistikë pra saktë të krijohet struktura që bën regjistrin e saktë të viktimave që kanë lindje, vdekje, biografi dhe këtë do ta quajtsa libri i kujtesës. Në anën tjetër të krijohet monumenti që unë do ta quajtsa muri i kujtesës. ku do të gdhendeshin emrat me gerrat të barabarta të të gjithë njerëzve të viktimizuar në këtë gjenocid. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Hamiti, për fjalë është paraqitur z. Emrush Xhemali**

**DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Z. kryesues, e përshëndes nismën e z. Kamberi dhe të deputetëve të tjerë, që të vihet një datë me këtë rast 27 prilli për kujtim dhe respekt martirëve të Kosovës të gjenocidit edhe të holokaustit serb. Nuk kisha diçka të shtoj tjetër ,por edhe unë kam menduar të njëjtën gjë që duhet nga ajo që është propozuar nga emri të bëhen ndryshime në kuptimin që i tha edhe deputeti z. Sabri Hamiti edhe z. Gjergj Deda dhe përafërsisht kam menduar para se të flasim këta që për këtë ditë të gjendet një term i përshtatshëm që unë do ta propozoja si dita e martirëve prej gjenocidit dhe holokaustit serb. Ju faleminderit.**

**KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Fjalën e ka deputetja Flora Brovina.**

**DEPUTETJA FLORA BROVINA – Ju faleminderit. Gjithashtu përkrah grupin i cili ka dalë në përkrahje të familjeve të personave të zhdukur. Kjo kërkesë që të shpallet një ditë kur ata do ta shënonin ditën e të pagjeturve është shumë e hershme. Me këtë rast nuk dua ta zgjas më tepër, kujtoj se datat, festat e Kosovës , datat e veçanta dhe të rëndësishme duhet të regjistrohen me ligj të veçantë. Ky është një obligim yni që edhe data nëse i quajmë të zhdukur unë kujtoj se plotësisht i përshtatet termi i gjenocidit ose një term tjetër që ma saktë e shpreh krejt kriminalitetin që ndodhi ndaj popullatës së pafajshme**

dhe të pambrojtur, duhet të jetë një ligj që e shënon këtë. Për këtë çështje të personave të **zhdukur** dhe çka ndodhi me ta, si qëndroi Parlamenti i Kosovës dhe institucionet e saj, duhet të debatohet në veçanti.

Kuvendi duhet t'i pyesë institucionet vendore sa e zbatuan rezolutën e nxjerr nga ky parlament. Kujtoj se edhe deputetët edhe ata që nënshkruan nuk u pyetën. Ma mirë kishte qenë që sot ,d.m.th. të ishte vetë kryeministri dhe ministrat dhe t'i pyesnim sa e zbatuan rezolutën e nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës?

Në bazë të kësaj rezolute, po të ishte zbatuar pikë për pikë ,ne do ta kishim edhe përgjigjen për datën 27 prill. Prandaj, kërkoj edhe një herë nga Kryesia e Parlamentit të debatohet për personat e zhdukur pikë për pikë sa është zbatuar rezoluta e nxjerrë para se vitesh në Parlamentin e Kosovës.

**KRYESUESI, XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit, për fjalë është paraqitur z. Hydajet Hyseni Kaloshi.

**DEPUTETI HYDAJET HYSENI** – Ju faleminderit z. kryesues. Nuk e kisha ndërmend të diskutoja për këtë çështje ,sepse ajo që duhej thënë edhe u tha. Por kam përshtypjen se po e zgjerojmë dhe po e shkapërderdhim së tepërmi çështjen dhe kështu nuk mund ta përmbledhim, nuk mund ta përthekojmë. Janë megjithatë dy çështje që për mendimin tim duhet veçuar.

Nisma e deputetëve e cila meriton respekt, meriton mbështetje që është edhe shprehje e kërkesës së asociacioneve të familjeve të të pagjeturve që të ketë një ditë në të cilën do të shënohet, do të kujtohen, do të aktualizohet çështja e të pagjeturve. Dhe çështja tjetër që po shtrohet këtu ,çka më tej, ligji për këtë ditë, ligji për të pagjeturit, për familjet e tyre, për të dëmtuarit të masakruarit, gjenocidin, por janë megjithatë një gamë çështjesh të tjera të cilat nuk mund të futen në këtë pako. Prandaj unë mendoj se ka kuptim të bisedohet për to, ka kuptim edhe për atë që e shtroi kolegja deputete sa është respektuar rezoluta e Kuvendit .P.sh. edhe gjatë procesit negociator , pse nuk është pasur kjo çështje në tavolinën e bisedimeve?. Mirëpo, dalim jashtë temës, unë prandaj propozoj, që ne të fokusohemi në nismën e deputetëve që Kuvendi të shpallë ditën e caktuar si ditë të të pagjeturve dhe kjo nuk i përjashton pastaj hapat e mëtejme. Ajo që unë do të sugjeroja është të kërkohet prej Qeverisë, se Qeveria ka një zyre të posaçme për këtë çështje që nëpërmjet kësaj zyreje të na përgatitë një ligj për këtë çështje dhe përveç kësaj ajo që kërkuan deputet që Qeveria dhe ministria përkatëse këtë çështje e ka marrë Ministria për Punë dhe Çështje Sociale mund të bëhet edhe me ministrinë e tjera të përgatisë ligjet për çështje tjera, siç janë perkujdesja për familjet e më tej, edhe për çështjen e gjenocidit. Por mendoj që nuk duhet të futen të gjitha në një pako, se sot ne duhet ta mbarojmë këtë çështje dhe çështjet e tjera le të iniciojnë në rrugë të rregullt procedurale. Ju faleminderit.

**KRYESUESI, XHAVIT HALITI** – Ju faleminderit z. Hyseni, fjalën e ka deputeti Ragip Zekolli.

DEPUTETI RAGIP ZEKOLLI – Ju faleminderit z. kryesues, unë vetëm desha të them dy çështje: E para që 27 prilli është dita e cila është ma e përafërt po them për tërë Kosovën edhe për tragjedinë që ka ndodhur, andaj do të ishte mirë që sot mos të dalim d.m.th. pa e zgjidhur këtë çështje apo qoftë edhe nëse mbetet edhe në seancën tjetër, por një çështje tjetër e cila u nxit këtu e ka mbetur pezull, vërtet është e dhimbshme ,sepse ne edhe më herët kemi ofruar mundësi që nëse hartohet ligji janë lajmëruar edhe donatorë të cilët donë të ndihmojnë.

Unë në këtë rast po e prezantoj qëndrimin . gjegjësisht Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur që janë të gatshëm ta ndihmojnë Parlamentin lidhur me hartimin e një ligji. Gjithashtu ekziston edhe një ligj po them kushtimisht mostër ,të cilin e ka Bosnja dhe mund të kihet parasysh lidhur me këtë çështje.

E fundit, çka është ma e dhimbshmjia ndër këto që u përmend. Vërtet unë mendoj se familjarët në Kosovë janë më të prekur si çdo kund në vendet e Ballkanit pasi kam pasur rastin të shoh edhe situatën në Bosnje, edhe në Kroaci, edhe gjithkund tjetër. Është i vetmi rast i paprecedent kur këta njerëz nuk kanë pasur qasje kurrë te ma të dashurit e tyre, qoftë kur është bërë identifikimi, qoftë kur janë bërë format e tjera. Andaj ligji është i domosdoshëm dhe mendoj që do ta ndihmonte këtë çështje. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. Zekolli, fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ – Unë do të bisedoj këtu dhe do ta përkrah akademik Hamitin i cili propozoi shumë qartë, për shumë arsye. Unë do ta përmend vetëm një faktografi në anën tonë ku në komunën e Klinës ka ndodhë një masakër dhe në atë masakër , përveç komunitetit shqiptar , kanë qenë edhe dy persona të komunitetit tim egjiptas të cilët janë vrarë dhe masakruar nga forcat serbe.

Dhe në atë fshat ka ndodhur një gjë që është ndërtuar një lapidar për një komunitet, ndërsa njerëzit e tjerë që kanë shkuar për atë ideal janë ndarë nga ato varreza. Për këtë arsye Kosovës i duhet një ligj për gjenocidin, për gjithë qytetarët që kanë kaluar në këtë periudhë të historisë. Kështu që nuk është mirë që secili subjekt politik ose secili individ të caktojë data të caktuara, sepse ata kanë shkuar për një ideal, kanë shkuar për një pavarësi të Kosovës, prandaj këtë mund ta rregullojmë ne deputetët e Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI –Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Sabit Rrahmani

DEPUTETI SABIT RRAHMANI - Ju faleminderit z. kryesues, i bashkëngjitëm mendimit të z. Neziraj, për propozimin që tha profesor Hamiti me të vërtetë zënë vend dhe unë mendoj që Kuvendi duhet t'i ketë parasysh. Sa i përket mocionit të ngritur nga deputeti Kamberi, është një nismë mjaftë e mirë, mirëpo këtu më dolën disa propozime rreth emërtimit, disa fjalë i tha z. Gjergj Dedaj disa fjalë i tha edhe Emrush Xhemali, unë mendoj që duhet të harmonizohen të gjitha propozimet e deputetëve. Nuk po e konteston askush 27 prillin po si të quhet, a të quhet ditë e të pagjeturve, apo ditë e të

vrarëve, apo si tha edhe zonja flora Brovina të zhdukurve. Problem është emërtimi në mendoj që nevojitet pak kohë konsultime në mes të deputetëve se si duhet të emërtohet dita e 27 prillit, a ditë e të pagjeturve që kanë ngritur emocionin z. Kamberi apo sipas propozimeve që dalën nga Kuvendi. Mirëpo pa i përsëritur gjitha gjana që i tha z. Teuta Sahatqija, unë mendoj që edhe këtu duhet të marrim parasysht të gjitha që i ceku ajo pa i cekur unë përsëri. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Fjalën e ka deputetja Gjulshe Berisha.

DEPUTETJA GJULSHEN BERISHA – Ju faleminderit z. kryesues, unë do të përshëndetja nismën që e ka marrë për mocionin deputeti Kamber Kamberi dhe deputetët e tjerë. Për realizimin të them të një prej kërkesave të këshillit koordinues të asociacionit të familjarëve të pagjetur të Kosovës që është një prej pikave ose një prej kërkesave të protestës që e kanë pasur dhe drejtuar Parlamentit me 4 janar 2007 dhe mendoj që me propozimin e këtij mocioni vetëm mund të themi se fillon dalë ngadalë t'i realizojnë kërkesat e këtyre familjarëve që vërtet edhe ua kemi borxh po edhe nuk bën, mendoj ,të debatohet aq shumë dhe të bisedohet për emocionet për të cilat ato i përjetojnë qe sa vite edhe sot sigurisht gjatë kësaj kohe. Mendoj që nuk duhet shumë debat rreth kësaj pike. E mbështesim mocionin, por në këtë mocion nuk kemi këtu të caktuar të thuhet se si do të shënohet kjo, sepse kam vërejtjen në atë se a do të jetë festë apo jo. Kjo nuk mund të jetë, kjo është vetëm një shënim që është i përkohshëm ,sepse duhet të rregullohet me ligj.

Jap përkrahje këtij propozimi dhe gjithashtu pas fjalës se deputetit nga LDK-ja kuptohet Sabri Hamitit, më duket çdo fjalë tjetër ka qenë e tepërt, krejt ka qenë e tepërt. Kjo është.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI –Ju faleminderit, për debatin dhe për mendimet e vlefshme. Unë mendoj që ka nevojë të nxirret ligji i cili përcakton standardet edhe për dëshmorët edhe për heronjtë e Kosovës edhe për viktimat edhe për të gjitha kategoritë që vërtet s'jemi si komunitet të dëmtuar, si popull, propozimi është të shpallet si vendim i përkohshëm. Ka propozime që të kërkohet me ligj. Z. Kamberi dëshiron më duket si propozues, sepse ma s'ka diskutime.

DEPUTETI KAMBER KAMBERI - Unë nuk desha të marr fjalën përsëri as të zgjati, mirëpo më nxitën disa deputetë si duket nuk kanë qenë të vëmendshëm pranë kësaj çfarë paraqita para jush dhe prej asaj çfarë kam paraqitur më 1 prillin e vitit 2006. Nuk është kërkesë imja. unë mund ta quajë vetëm si një zëdhënës i shoqatave që kanë pasë fatin e keq dhe ta ndiejnë pjesën e dhembjes aq të madhe për të zhdukurit apo për të rrëmbyerit e tyre. Unë e kam autorizimin e shoqatës të 27 prillit, e keni pasë të gjithë deputetë edhe kërkesën e shoqatave të tjera për të pagjeturit e Kosovës. Prandaj me gjithë diskutimet që i kemi bërë me disa deputetë si duhet të emërtohet kjo datë -ditë e të pagjeturve apo e të zhdukurve .besoj se duhet të respektohet kërkesa e shoqatave që e keni të gjithë para vetes që 27 prilli të jetë ditë e të pagjeturve të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – S'ka replikë. Nuk iu ka përmendur emri ju lutem. Jo s'ju ka përmendur emri dhe s'ka replikë. Ju lutem. Unë nuk e kam dëgjuar se ju ka

përmendur emri. Ju lutem unë kërkoj mirëkuptim. Këtu janë disa që kanë qenë kundër, kanë interpretuar në mënyra të ndryshme, qysh nuk ju ka pëlqyer. Unë jam këtu për me ua dhënë fjalën për me diskutuar për çështje, por replikë nuk ka, sepse nuk jua ka përmendur emrin. Unë e dëgjova shumë mirë dhe ky u përpoq ndoshta në interpretim e ka thënë një fjalë, se besoj se nuk ka nevojë për shpjegim tonin. Është përpjekë mendoj me na sqaruar se çfarë ka propozuar dhe cila është kërkesa e tyre. Megjithatë për të mos u keqkuptuar edhe unë edhe këta, urdhëroni e keni fjalën Teuta Sahatqija, dhe vazhdojmë me votimin.

DEPUTETJA TEUTA SAHATQIJA – Ju faleminderit z. kryesues, mendoj që nuk ka kurrfarë nevojë të arbitrimit apo të frikës prej asaj se çka do të thuhet. Nuk e pata mendjen, ne përsëri po e rikonfirmojmë, ne e mbështesim nismën. Është nismë jashtëzakonisht e mirë edhe e mbështesim atë, i mbështesim edhe ato shoqata dhe familjarët të cilat e kanë kërkuar, por deputeti i cili i di procedurat e ka pasur për detyrë që mos t'i qesë në pozitë të keqe ata familjarët, por t'i udhëzojë cilat janë procedurat normale në Parlament. Ne vetëm këtë po e kërkojmë edhe secili që u ngrit e përshëndeti këtë nismë që kjo të bëhet në mënyrë ligjore. Nuk ka pasur asgjë aty kush e ka kuptuar kush nuk e ka kuptuar, e kemi kuptuar jashtëzakonisht mirë edhe mesazhi është shumë i favorshëm për të gjithë. Me nismën ligjore jo me individuale, apo me zgjidhje të përkohshme të kryhet me ligj në mënyrë procedurale parlamentare. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI –Unë e kam për detyrë që t'ju sqaroj, që kërkesa e ardhur në mënyrë jo të rregullt sipas procedurave që parasheh Rregullorja e Kuvendit, nga Kryesia është kthyer pas dhe është nënshkruar nga 7 deputetë dhe mendoj proceduralisht ka qenë me rregull dhe propozimi është që të jetë një vendim i përkohshëm. Sipas të gjithë diskutuesve deri më tash, propozimin unë e kam për obligim ta hedh në votë. Votimi do të jetë elektronik dhe para se ta hapim votimin ju kisha lutur edhe juve si kolegë edhe sekretarinë e Kuvendit që të gjithë deputetët t'i furnizojë me tre kartonë, një të kuq, një të gjelbër, dhe një të verdhë, sepse një pjesë që s'po marrin kartela me vete nuk po dihet për çka po votojnë kur pe ngrisin dorën dhe kur po bëhet votimi formal ia lehtëson drejtuesit të seancës t'i numërojnë votat për, dhe kundër, dhe nuk ka nevojë me u përsëritë. Megjithatë që po e them është e tepërt teknika hapeni votimin ju lutem.

Ju lutem votoni

Në sallë janë 75 deputetë. E hedh propozimin e bërë nga 7 deputetë që Kuvendi i Kosovës me një vendim të përkohshëm deri në rregullimin me ligj të datës të shpallë: 27 prillin Ditë e të pagjeturve të Kosovës.

Votojmë tani.

Për..... 68  
Kundër ... 1.  
Abstenojnë 5

Miratohet propozimi për vendim të përkohshëm që:

## **27 prilli të jetë Ditë e të pagjeturve të Kosovës.**

Ju faleminderit.

Dhe në fund kemi njoftimi e Kryesisë ,siç e keni të paralajmëruar -në pikën 11 të rendit të ditës.

### **11. Njoftim për vendimin e Kryesisë së Kuvendit për rishpallje të konkursit për emërimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësit të tij kryesor.**

Konstatime hyrëse: Në pajtim me përfundimin e seancës plenare të mbajtur me 14 dhjetor 2006 Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur me 5 shkurt diskutoi lidhur me procedimin e mëtejshëm për emërimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësit kryesorë të tij.

Kryesia e Kuvendit konsideron se konkursi duhet të rishpallet, ndërsa nga UNMIK-u është kërkuar që të saktësohen procedurën e votimit që ndërlidhet me nenin 6 të Rregullores për Avokatin e Popullit në Kosovë. Vendimi i Kryesisë së Kuvendit u është shpërndarë të gjithë deputetëve për njoftim në pajtim me rregullat procedurale për zgjedhjen dhe emërimin e Avokatit të Popullit. Me kaq konstatoj që seanca e sotme ka përfunduar, Nesër vazhdojmë seancën në orën 16. Ju faleminderit.

Me kërkesë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, me kërkesë të anëtarit të Grupit Negociator të Kosovës, z. Hashim Thaçi, me kërkesë të kryetarit të PDK-së, na është lutur të gjithëve përmes meje, kryetarit të Grupit Parlamentar dhe Grupit Negociator mendoj se edhe janë marrë vesh në mes veti me sa di unë, na janë lutur që të shtyhet për arsye që dihet një pjesë e deputetëve të Partisë Demokratike të Kosovës janë të zënë në mëngjes dhe kryetari është në udhëtim zyrtar. Prandaj po kërkojmë mirëkuptim në kërkesën tonë dhe në kërkesën e kryetarit të PDK-së. Mendoj që duhet ta miratojmë në qoftë se gjejmë mirëkuptim tek ju, sepse është dëshirë jona dhe e tij që të jetë komplet Grupi Negociator . Urdhëro z. Hamiti.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Ju lutem shumë, z. kryesues, z. Haliti, kolegu im i nderuar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Ne kemi pasë një mbledhje të përbashkët të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës bashkë me shefat e grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës, në të cilën njëzëri kemi vendosur që për dokumentin e Ahtisarit të bisedohet ditën e premte ora 10. Njëzëri e them me qëllim, sepse kanë filluar njerëzit t'i ndërrojnë fjalët, dhe për të mos ndërruar fjalët këto biseda tona të gjitha regjistrohen dhe bëhen në letër dhe janë anëtarët e PDK-së në qofshin si anëtarë Kryesie ose të grupit parlamentar që e kanë kërkuar të premtën në orën 10.

Unë le të vendoset si të dojt, por unë e dua instancën kush po vendos, unë dua ta di a vendos i njëjti organ që e ka caktuar atë mbledhje apo vullnetarët që kanë qejf. Dikush është zanë para dite dikush pas dite, ndoshta edhe unë jam i zënë pas dite nesër dhe do të

lypsha mos me u mbajt mbledhja, shkurt po dua institucionalizim ma së pari dhe ma së miri nga ata që e kanë kërkuar vetë ditën e premte në orën 10, le të mblidhet Kryesia që e ka për detyrë dhe le ta caktojë mbledhjen edhe në 5, jo në 4, por edhe në 6. Është punë kur vendoset, unë nuk e paragjykoj po edhe një herë po them **mos** të mbetet trajtim gojor një problem kaq i rëndësishëm, por institucionalisht le të caktohet. Ky është mendimi dhe bindja ime, Ju faleminderit shumë z. kryesues.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit, unë jam plotësisht dakord me propozuesin. Kërkoj gjysmë ore pauzë, që Kryesia të mblidhet dhe unë nuk di tjetër zgjidhje. Nuk është hapur debat lidhur me këtë çështje, Alush a ke ndonjë propozim tjetër ti, përveç propozimit të Sabriut.

DEPUTETI ALUSH GASHI – Z. kryesues, transkripti nga mbledhja e Kryesisë së Kuvendit me shefat e grupeve parlamentare, transkripto të cilin e kam këtu, e konfirmon atë që e tha anëtari i Kryesisë dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës z. Sabri Hamiti. Pas asaj mbledhjeje është kuptuar se z. Rohan do të ketë takim me Ekipin e Unitetit ditën e premte në ora 10 dhe vlerësimet janë që ato takime zgjasin ma tepër një orë a dy, kështu që varianti i parë i mbajtës së mbledhjes së Kuvendit për të debatuar atë çështje do të ishte diku para orës 12 dhe në ndërkohë sot është bërë e ditur se një delegacion i Kongresit Amerikan do të jetë nesër këtu dhe lutja e kryetarit të Kuvendit në bashkëbisedim me ju ,si edhe kërkesën nga një anëtar i Delegacionit të Unitetit në këtë rast nga Partia Demokratike z. Thaçi ishte që pasi seanca edhe ashtu nuk mund të fillojë para orës 12 dhe pushimi i drekës e tjera që seanca të fillojë në ora 14, ora 14. Këtu u përkthye në ora 4 pas dite. Unë e di për nesër 14, cilado orë qoftë nesër duke llogarit që natën një numër i deputetëve udhëton pak larg, ne kemi deputetë nga Dragashi që i kanë së paku dy orë deri atje paraqet ndonjë vështërsi eventuale.

Sa i përket procedurave si dëshironi, ne mund të vijmë nesër në ora 10 dhe ta fillojmë mbledhjen atëherë kur mundet me ardhur Delegacioni i Unitetit, por jemi të sigurt se kryetari i Kosovës , shefi i delegacionit të Unitetit do të jetë në takim së paku deri në mesditë. Ju faleminderit.,

KRYESUESI, XHAVIT HALITI – Ju faleminderit. Janë paraqitur edhe 8 veta për të diskutuar lidhur me këtë çështje. Gjitha qëndrojnë edhe këto që tha z. Hamiti edhe këto që tha z. Gashi, unë po interpretoj një bisedë një marrëveshje gojore një kërkesë të kryetarit të Partisë Demokratike, dhe unë besoj që gjej mirëkuptim te të gjithë ju, bën z. Xhemaili një pyetje. Të lutem dy vetë të LDK-së e patën fjalën para teje, tash po ju jap fjalën të tjerëve, edhe ty menjëherë do ta jap fjalën, tre vetëve menjëherë nuk mund tu jap fjalën. I Pari është Hydajet Hyseni, i dyti Fetah Berisha, i treti Nazim Jashari, i katërti Gazmend Muhaxheri, Agim Krasniqi, Gjylnaze Syla, Ymer Muhaxheri, në qoftë se jeni të kënaqur,

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – Pyetja është kështu, nëse na e fillojmë mbledhjen në ora 16 si u propozuar në 14, mendoj se është shumë e pamjaftueshme që të debatohet për temën të cilën e kemi caktuar, për pakon e Ahtisarit, sepse është një temë në të cilën duket si sot se ka shumë të interesuar me diskutua, kështu që meqenëse tek janë të zënë



edhe nuk janë bashkë të përqendruar nesër ekipi i Unitetit do të ishte mirë që këtë mbledhje me lanë për të shtunden në ora 10,00,

KRYESUESI, XHAVIT HALITI- Fjalën e ka Hydajet Hyseni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit z. kryesues. Unë kam kërkuar fjalën për pikën e mëparshme të rendit të ditës, nuk ma dhatë, dhe të jeni të sigurt se nuk do t’ju marrë shumë kohë se e kuptojë edhe gjendjen tuaj të nderuar deputetë.

Megjithatë dua ta shfrytëzojë drejtën time vetëm për të thënë se nuk e konsideroj të drejtë që nuk e informuat tërësisht për vendimin e Kryesisë, dhe unë dua ta theksojë këtu hapur se vendimi i Kryesisë është i lëndueshëm, për mos e zgjatur vetëm dua t’ju bëjë me dije se :gjella është pa krip, nuk dua të marrë pjesë në të. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI- Ju faleminderit z. Fetah Berisha e ka fjalën.

DEPUTETI FETAH BERISHA – Z. kryesues. Ju faleminderit që ma dhatë fjalën, këtu na dolën tri variante. Është ora 10, është ora 14, prandaj është ora 16, prandaj unë mendoj të merret ora 14 pas dite ose deputetëve për këtë temë shumë të gjerë në qoftë se vazhdohet me orën 16 ne këtu do të rimë deri vonë natën, atëherë Kryesia e Parlamentit le t’ju sigurojë deputetëve edhe fjetjen, nëse jo atëherë le të shtyhet për një ditë tjetër. ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI- Jam plotësisht dakord me këtë që e thatë dhe në qoftë se shihet e domosdoshme parlamenti ndonjë herë duhet të rijë edhe deri në mëngjes, ta shohim. Fjalën e ka z. Nazim Jashari.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Z. kryesues, mendoj se nuk jeni duke e udhëhequr seancën si duhet, se jeni duke e keqpërdorur foltoren, mendoj se po mundoheni ta bini Kuvendin para aktit të kryer. Të gjitha këto nuk ju kanë hije dhe nuk ju bëjnë nder, puna e parë është kjo, puna e dytë. Ky Kuvend i merr vendimet në mënyrë sovraane dhe të plotfuqishme dhe vendimi që është marrë në Kryesi të Kuvendit u miratua në fillim të kësaj seance që rendi i ditës është ky dhe vazhdohet me procedurën e njëjtë edhe për rendin e ditës për nesër. Prandaj në qoftë se ato që i tha z. Berisha para meje, në qoftë se ju mendoni që ne duhet të punojmë edhe pas dite dakord shumë dakord, mirëpo duhet të hiqen shpenzimet për deputetët, sepse ka kuvende të botës që nisin mbledhjen në 8 të natës dhe vazhdojnë deri në mëngjes, po ne se kemi atë praktikë sepse te ne shpenzimet nuk hiqen, duhet ta kemi të qartë këtë punë, tjetër, në qoftë se z. Hashim Thaçi prej Izraeli e bien pavarësinë, ne jemi në dakord ta presim të gjithë, por në qoftë se vetëm duhet të jetë këtu sa për t’u ditur se pa të nuk bën, nuk jemi dakord. Mbledhja duhet të shkojë mbledhja duhet të vazhdojë kur të vijë i bashkëngjitet dhe merr fjalën e vet dhe flet.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI- Sa për hije nuk jam me më pas hije këtu. Unë jam me udhëhequr mbledhjen dhe unë ta interpretova rregulloren ashtu si e ke miratuar sepse ke qenë anëtar i Komisionit vetë, lexo edhe një herë po të porosisë, por sa për hije hiq

absolutisht nuk jam kah lodhem se si më ka hije mua, po është e saktë ajo si ta kam interpretuar unë, e jo si e the ti, dhe s'ke nevojë me bërtit fare, për fjalë është paraqitur Gjylnaze Syla.

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit. Mendoj se seanca duhet me marrë vendimin tani se kur do ta kemi nesër debatin dhe unë propozojë pasi që z. Gashi e shpjegoj se deri në ora 12 Ekipi i Unitetit ka takim me Rohanin ,atëherë në ora 1, edhe të vendosim të votojmë.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI- Fjalën e ka deputeti Ymer Muahaxheri.

DEPUTETI YMER MUHAXHERI – Z. kryesues, Kuvend i nderuar, jam i mendimit se nuk duhet me i komplikuar gjërat, u arsyetua termini për në orën 2, është dashur të qitet në votim dhe me mbaruar kaq. Ju faleminderit profesor.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI- Unë ashtu mendova. mirëpo u paraqitën këtu për diskutim nuk po di kur po i shkeli drejtat e njeriut, as të drejtat e deputetit, duhet me respektuar një farë rendi z. Gazmend Muhaxheri.

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit koleg, anëtar i Kryesisë. Kryesia e Kuvendit në bashkëpunim me shefat e grupeve parlamentare ka caktuar seancën e rregullt të premten, në orën 10. Mendoj se seanca duhet të fillojë të premten në orën 10 siç e kemi caktuar, anëtarët e Ekipit të Unitetit e dinë që duhet me ardhur të premten në orën 10, mund të kenë obligime, ne si deputetë mund të fillojmë diskutimin edhe pa ta, sepse jemi për të shprehur mendimet tona dhe si rezultat i debatit t'i japim edhe rekomandime ose sugjerime Ekipit të Unitetit për qëndrime që do t'i mbajnë në Vjenë. A do t' i thonë ato qëndrime në fillim të seancës apo në fund të seancës u takon atyre kur kanë kohë me i thanë ato qëndrime, mirëpo ne si deputetë kemi të drejtë të diskutojmë edhe nuk mund që për hir të dikujt të kufizojmë edhe kur të fillojë diskutimi në ora 4 ndoshta vetëm flasin shefat e grupeve parlamentare edhe ta përmbyllim këtë diskutim. Nëse jeni të bindur se do të siguroni që prej orës 4 e derisa të ketë diskutues të interesuar për me folë mundet me u mbledhë Kryesia e Kuvendit edhe me pru një vendim me votim formal, ose me konsensus pa u mbledhur Kryesia e Kuvendit dhe me marrë një vendim tjetër, nuk mundet me u shty seanca e së premtes që është caktuar të fillojë në orën 10. Ju faleminderit

KRYESUESI, XHAVIT HALITI- Kryetari i Kuvendit po i thirr anëtarët e Kryesisë në mbledhje në kabinetin e tij, deputetë në qoftë se duan me interpretuar ndryshe vendimin e Kryesisë e kanë mundësinë me votuar pas vendimit të Kryesisë. Ju ftoj që të shkojmë të gjithë në kabinetin e kryetarit.

Ju faleminderit.

